

JERONDËT

PORFIR († 1906 - 1991) & PAIS († 1924 - 1994)

# FUQIA E RRËFIMIT

Nevoja për drejtues shpirtëror

UDHËZUES RRËFIMI

**Aleksandrupoli 2011**

Jerondët Pais († 1924 – 1994)

& Porfir († 1906 - 1991)

# FUQIA E RRËFIMIT

Nevoja për drejtues shpirtëror

UDHËZUES RRËFIMI

**Aleksandrupoli 2011**

Koordinimi i teksteve: Mavrokefalos Anestis

Cel. 697 3740058

Cel. 695 5319555

*Falënderojmë të gjithë ata që na ndihmuan, me çdo lloj mënyre, në botimin e librave të jerondëve Pais dhe Porfir.*

# PËRMBAJTJA

## BIOGRAFI E SHKURTËR

E Jerond Paisit.....

## KAPITULLI 1

Nevoja për drejtues shpirtëror.....

## KAPITULLI 2

Për një rrëfim të saktë.....

## KAPITULLI 3

Doktori i shpirtit.....

MESAZHI i Jerond Paisit.....

## BIOGRAFI E SHKURTËR

E Jerond Porfirit.....

## RRËFIMI – PENDIMI

Jerond Porfiri.....

## RRËFIMI

Misteri i pajtimit.....

## RRËFIMI I PASTËR

Mësime nga Shen Kozmai i Etolisë.....

UDHËZUES RRËFIMI.....

## BIOGRAFI E SHKURTËR

Jerondi i lumur Pais, emri i tij i mëparshëm në botë ishte Arsen Eznepidi, lindi në Farasa të Kapadhokisë më 25. 7. 1924. Pas shkatërrimit aziatik, popullsitë greke, pas afërsisht 2.500 vjetësh prezence të vazhdueshme në zonë, në mënyrë që t'ju shmangeshin përndjekjeve dhe vrasjeve të Turqve, detyrohen të gjejnë strehë si të shpërngulur në shtetin e sotëm Grek. Familja e Jerondit u vendos përfundimisht në Konicë të Epirit, vend në të cilin dhe u rrit.

Ashtu siç kishte profetizuar edhe Shën Arseni i Kapadhokisë, i cili dhe e pagëzoi, Jerondi e shfaqti prirjen e tij që në moshë të vogël. Vitet fëmijore i jetoi me kujdes shpirtëror, me lutje, me keshmë dhe me pasion për jetën asketike.

Shkoi ushtar gjatë kohës së luftës për katër vjetë.

Rreth moshës 30 vjeçare u bë murg në Malin e Shenjtë. Kaloi shumë vështirësi dhe sprova por gjithashtu pati dhe mbështetje të shumtë hyjnore. Asketizoi gjithashtu edhe në Konicë, në Manastirin e Hirshëm të Stomiut. Atje ushqente arinj të egër me duart e veta. Paqja, që Shpirti i Shenjtë buronte në shpirtin e tij, paqësonte edhe kafshët e egra. «...nëse u afrosh edhe kafshëve të egra me dashuri, ato e kuptojnë dhe nuk të ngacmojnë... », më tha dikur për këtë ngjarje. Ne të rinj apo të moshuar le të mos mendojmë që të imitojmë këtë gjë sepse egërsia e pasioneve, që mbartim në shpirtrat tanë, do ti «egërsojë» kafshët dhe do të rrezikojmë.

Për afërsisht tre vjetë shkoi në shkretëtirën e Sinait, në shpellën e Shën Epistimit. Të dielave zbriste në manastirin e Shën Ekaterinës ndërsa gjithë pjesën tjetër të javës luftonte i vetëm në

qetësinë e shkretëtirës. Herë pas here e vizitonte dhe ndonjë Beduin, dhe i jepte lëmshë nga ato shumë pak që kishte. Madje dhe uji që kishte ishte i paktë. «...atje midis thatësisë së shkretëtirës admirova përkujdesjen e Perëndisë. Ekzistonte në një shkëmb një e çarë që pikonte pak ujë, atje vendosja një kanë për gjithë natën dhe mblidhja ujin që kisha nevojë...më mjaftonte...nuk më nevojitej më tepër».

Në shkretëtirën e Sinait Jerondi pati shumë përvoja hyjnore por edhe beteja të mëdha dhe të hapura me Djallin. Përgjithësisht, besoj se betejat asketike të jerondit tejkalojnë në një gradë të madhe mentalitetin e pamësuar me beteja dhe përpjekje dhe njerëzit e pamësuar e të dobët. Jerondi ishte me të vërtetë një luftëtar i madh. Betejat e tij shpirtërore krahasohen vetëm me luftrat e asketëve të vjetër të shekullit të 4-t pas Krishtit.

Për ne, me mentalitetin tonë të dobët, është e tmerrshme dhe sikur vetëm ti dëgjojmë!!!...

Dëgjova se Jerond Porfiri (Malakasa), me përlësinë e tij të madhe kishte thënë për Jerond Paisin: Hiri që ka at Pasi ka më tepër vlerë, sepse e fitoi me betejat e tij (luftrat shpirtërore), ndërsa mua ma fali Perëndia që në moshë të vogël që të ndihmoj njerëzit.... Shenjtorë të tillë (si at Pasi) Perëndia dërgon në tokë një herë në 400 vjetë!!!...

Në Malin e Shenjtë asketizoi dhe kaloi vitet më të shumta të jetës së tij. Hiret me të cilat vetë Perëndia e kishte stolitur ishin të shumta. **Kishte hir shërues** (shëroi shumë nga sëmundje të ndryshme, me kancer, të paralizuar që në lindje, etj.), **kishte hir kundër demonëve** (kur akoma ishte në jetë nxorri prej mjaft njerëzve shumë demonë), **kishte hir parashikues** (tek shumë njerëz parashikoi shumë ngjarje që do t'ju ndodhnin në të ardhmen, ngjarje personale por gjithashtu profetizoi edhe

zhvillime të ardhshme në historinë e atdheut tonë), **kishte hir tejshekues** (njihte zemrën e çdo njeriu më thellë dhe më pastër se sa mund ta njihte dikush veten e vetë, prandaj dhe këshillonte saktë dhe me përpikmëri dhe kushdo dëgjonte fjalët që kishte me të vërtetë nevojë të dëgjonte prej tij), **kishte hirin e dallimit të shpirttrave** (dinte saktësisht nëse një ngjarje shpirtërore ishte nga Perëndia apo nga i ligu që përpiquej që ta mashtronte dhe ta bënte për vete, **kishte hirin e dallimit** (njihte në çdo rast cila ishte dëshira e Perëndisë dhe nëse duhej që ta shfaqte apo jo. Dinte në çdo rast se çfarë ishte e drejtë dhe e mirë madje edhe për çështje jo shpirtërore.

**Kishte hir teologjik.** Nga përvojat e shumta me Shenjtorë, me Engjej, me të Tërëshenjtën por edhe me shumë vegime të Dritës së pakrijuar, ishte bërë teolog i vërtetë dhe njihte në thellësi misteret e Perëndisë.

Nëse do të përpiquej që të numërojme hirit dhe fuqite e Jerondit nuk do të gjejmë fund. Mos mendoni se ky përcaktim është hiperbolik apo i tepruar... jo, është vetëm e vërteta. Perëndia është ai që e kishte stolitur dhe e kishte nderuar Jerondin me kaq shumë hire dhe dhuratat e Perëndisë mund të jenë të pafundme dhe të pakufishme.

Midis gjithë hireve të Jerondit, ajo që mua më bëri më tepër përshtypje ishte dashuria e tij. Një dashuri pa kufi, pa ngurrim dhe me vetflijim absolut. Një dashuri si zjarr, e ëmbël, e plotfuqishme, hyjnore. Një dashuri që buronte nga brendësia e tij pa dallim, një dashuri që i përqafoje të gjithë ashtu ngrohtë si njerëzit e mirë ashtu edhe ata të këqij, miqtë por edhe armiqtë e tij, njerëzit e tij të afërm e të njohur por edhe të huajtë, të denjtë por edhe të padenjët, orthodhoksët por edhe të feve të tjera, njerëzit por edhe kafshët e bimët por mbi të gjitha donte Perëndinë. Kjo dashuri nuk ishte

njerëzore. Dashuri të tillë vetëm Shpirti i Shenjtë mund të lind në zemra njerëzore. «Dashuritë» njerëzore janë kaq shumë të vogla dhe me interesa, kaq të përkohshme dhe të paqëndrueshme, kaq egoiste dhe nxitëse dhe shndërrohen shumë lehtë në antipati dhe urrejtje saqë është turp dhe e padrejtë ti krahasojmë me dashurinë e Jerondit.

Këto hire dhe kjo dashuri ishin arsyet që Jerondi mblidhte njerëzit pranë tij. Qindra njerëz e vizitonin çdo ditë në qelinë e tij. Një karvan i pafund njerëzish që shkonin e vinin. Jerondi mblidhte dhimbjen, agoninë dhe problemet e njerëzve dhe iu jepte zgjidhje problemeve, gëzim dhe paqe. Kur por edhe kudo që kishin nevojë, kudo ku duhej, ai dhe Perëndia e dinte se ku duhej, mrekullisht me pushtet hyjnor zgjidhte te pazgjidhshmet.

Me qindra janë njerëzit që kanë dorëzuar, të shkruara edhe me emër dëshmitë dhe historitë e tyre për mrekulli që lidhen me At Paisin. Libra të tillë janë botuar. Megjithatë ata që nuk kanë folur, të ndodhurat që Jerondi me teknika të shumta i fshinte janë shumë më tepër. Jerond Pasi ishte dhuratë e Perëndisë për njerëzit.

Fama e tij kishte tejkaluar Greqinë. Vinin që ta takonin dhe të këshilloheshin njerëz nga Australia, nga Sh.B.A-ja, nga Kanadaja, nga Gjermania, nga Rusia, Rumania, Franca, Afrika dhe nga të gjitha anët e botës. Kishte famë botërore. Dhe të gjitha këto pa u përmendur për të asnjeherë nga ndonjë radio, televizion, gazetë apo ndonjë mjet tjetër shtypi kur ishte ende gjallë. Mjetet e komunikimit shfaqin dhe zmadhojnë vetëm gjërat negative të njerëzve të kishës, ndërsa pozitivet, mrekullitë, të Shenjtat, nëse nuk mund ti përgënjeshtrojnë apo të shpifin i lënë pas dore, dhe i dënojnë në burgun e heshtjes. Megjithatë... ashtu si njerëzit kanë mënyrat dhe teknikat e tyre ashtu edhe Perëndia ka mënyrat e Tij.



Fama për Jerondin u përhap gojë pas goje, nga njerëz që mbetën të mahnitur nga bamirësitë dhe mrekullitë e tij... Jerond Paisin e bëri të njohur dhe e shfaqti vetë Perëndia.

Kur dilte jashtë Malit të Shenjtë që të takonte gratë dhe të sëmurët që nuk mundeshin që ta vizitonin në qelinë e tij, me mijra njerëz shkonin të mernin bekimin e tij. Makinat që parkoheshin në anët e rrugës e kalonin një kilometër gjatësi. Vazhdimisht shkonin e iknin makina në Manastirin e Shën Joan Theologut, në Suroti të Selanikut. Mijra njerëz që u bamirësuan. Me mijra dhe letrat që u dërguan. «...probleme psikologjike, kancere, familje të ndara..., një nga këto të treja do jenë dhe problemet e njerëzve..., këto i mundojnë në ditët tona njerëzit..., këto më shkruajnë». Dhimbja mbledhej tek Jerondi nga vetë njerëzit ose me anë të letrave. Dhe ai e ngrinte atë vuajtje me vetsakrificë..., me gatishmëri. Nga dashuria që kishte për të tjerët dhimbjen dhe vuajtjet e tyre i bënte dhimbje të tijën. Nuk mundej dhe nuk dëshironte të rrinte me duartë kryq kur njerëzit përreth vuanin. Nëse ishte e mundur, ia ngarkonte vetes së tij gjithë peshën e kryqit në mënyrë që njerëzit e tjerë të mos vuanin.

Jerondi, ndërkohë shëronte të tjerët, nuk i lutej Perëndisë që të shëronte veten e tij..., dëshironte që ti duronte të gjitha sëmundjet. «...të nxjerrim ndonjë para shpirtërore...që ta kemi për në pleqëri», thoshte me shaka. Që kur ishte ushtar vuante nga i ftohti dhe ethet, për një fije iu shmang prerjes së këmbës, dhe që atëherë i dhembnin shputat e këmbës. «Më duket sikur eci mbi gozhdë...prandaj dhe e vendos peshën e trupit një herë tek thëmbrat, një herë tek majat e gishtave dhe një herë në pjesët anësore të këmbës» më tha dikur duke qeshur..., megjithëse vuante nuk ulej kurrë në stolin e kishës... Qëndronte në këmbë për orë të tëra gjatë gjithë agripnive. Me këtë mënyrë u mësoi dhe brezave të rinj frymën lufatarake.

Jerondi kishte shumë sëmundje por i duroi të gjitha me shpirt luftarak duke përbuzur dhimbjen dhe duke u tallur me të!!...

Një herë që vuante nga dhjamthi, nga dhimbjet e shumta e lidhte barkun me disa copra rrobash dhe nuk shkonte tek doktori. Më vinte shumë keq kur e shikoja që vuante dhe i lutesha që të shkonte të vizitohej. Atë kohë filloi të më tregojë për sëmundjen në një mënyrë kaq qesharake dhe mospërfillëse ndaj sëmundjes sa që në fund qeshja edhe unë pa fund.

Vitet e fundit të jetës, në pleqërinë e tij, u sëmur me kancer. Unë por edhe shumë të tjerë që e njihnim besojmë se Jerondi e kërkoi nga Perëndia që të lehtësonte barrën e njerëzve të tjerë që vuanin. Dikur më kishte thënë «kur lutesh për një të sëmurë që ta bëjë Perëndia mirë duhet të lutesh me pasion të tillë madje ti thuash Perëndisë, “hiqe sëmundjen prej tij dhe ma jep mua” ose të paktën “më jep një pjesë të saj, që ta lehtësoj sadopak... Perëndia i tërëmirë që shikon dobësinë tonë e shëron njeriun për të cilin lutemi dhe neve nuk na ngarkon... por disa herë mund të na japë... kur e shikon që ne mund ta mbajmë atë vuajtje... “Duhet të kemi pasion të tillë që të dëgjohet lutja jonë...».

Kjo dëshirë, ky pasion janë vetflijim dhe Jerondi këtë e kishte me tepricë. Me dëshirë i ngarkonte dhe mbante me gëzim dhimbjen dhe sëmundjet e mijra njerëzve që e vizitonin. Jeta e tij ishte një ofertë për të afërmin.

Për sëmundjet e tij nuk fliste kurrë. I fshinte që të mos na shqetësonte dhe kur ne e kuptonim dhe nuk mund të fshihej, i paraqiste si diçka krejt të parëndësishme. Kështu bëri edhe me kancerin derisa filluan hemoragjitë dhe filloi të humbte ndienjat.

Të gjithë e kuptonim që ishte i sëmurë. I luteshim të gjithë të shkonte të kurohej..., asgjë nuk bënte. Kur u përhap se vuante nga

kanceri, filluan të shkonin shumë doktorë në Malin e Shenjtë që ta bindnin në mënyrë që ti lejonte ta vizitonin. Një herë erdhi një patolog, profesor në universitetin e Athinës vetëm për Jerondin, te cilin deri në qelinë e tij e shoqërova unë. Përfundimisht as ai nuk ia arriti ta bindte. Shkuan dhe shumë doktorë të tjerë por përsëri pa asnjë rezultat.

Në fund filluan ta nxisnin që të pranonte përkujdesje mjekësore dhe shumë personalitete të ndryshme me pozita të larta kishtare. Thuhet se vetë Patriarku, i propozoi të vizitohej.

Më në fund një doktor, njeri shpirtëror, që kuptonte ndjeshmërinë e Jerondit, i tha se nuk do ti bënte asgjë më tepër se sa do ti bënte një njeriu të rastit me siguracion bujqësor. Mendoj se ndjeshmëria e Jerondit nuk e lejonte që të pranonte një përkujdesje mjekësore, do ta pranonte vetëm në rastin që do ishte e njëjtë me atë që përfiton njeriu më i varfër. E konsideronte padrejtësi. Dhe në të vërtetë është e padrejtë dhe është një tregues tjetër i zemërngurtësisë që kemi ne njerëzit e sotëm. Ndërsa ne dhe njerëzit tanë të afërm të kemi doktorët më të mirë, të varfërit të hidhen në ndonjë krevat nëpër koridoret e ndonjë spitali dhe në shtete akoma më të varfëra të vdesin që foshnjë nga mungesa e ilaçeve. Padrejtësia, që është rezultat e botës së mbrapshtë shpirtërore të njeriut mëkatar, ekziston kudo në botë... por drejtësia hyjnore pret me durim që ti vendosë gjërat në vendin e tyre të duhur. Amin.

Përfundimisht Jerondi u operua nga kanceri. Besoj se këtë e bëri më tepër që të bindej dhe të mos mërziste të tjerët sesa nga dëshira e vetë. Dhe në këtë formë na mësoi mënyrën se si të përballojmë sëmundjet.

Kur e kapnin dhimbjet e tmerrshme psalte që të mos bërtiste dhe mërziste të tjerët. Ishte shumë i ndjeshëm. Nuk donte që të bëhej barrë dhe të mërziste ndonjë njeri.

Dikush lutej që ti jepte Perëndia një pjesë të dhimbjeve të Jerondit, që ta lehtësonte sadopak nga dhimbjet dhe pa dijeninë e Jerondit. Kur u takuan, pa diskutuar më parë Jerondi drejtohet dhe i thotë : «Mos kërk... Këto dhimbje nuk durohen... Mos u lut... nuk mundesh ti durosh... Prandaj mos kërk prej Perëndisë diçka të tillë».

Disa ditë para se të vdiste, shkuam të gjithë dhe morëm bekimin e tij për herë të fundit. Vdiq në 12 Korrik të vitit 1994 dhe u varros në oborrin e Manastirit së Hirshëm të Shen Joan Theologut, në Suroti të Selanikut.

Sot varri i tij është vend faljeje për njerëzit. Sa herë që gjatë këtyre viteve shkova atje, gjithmonë kishte njerëz që faleshin.

Jerond Paisi vazhdon të bëjë mrekulli dhe pas vdekjes së tij, ashtu si tek varri por edhe në vende të tjera. Shpresoj që së shpejti të vërtetohen ngjarjet që ndodhën pas vdekjes së tij, për lavdi të Perëndisë dhe për dobi të njerëzve të epokës sonë që dyshojnë, të cilët gjenden në një nevojë të madhe shpirtërore dhe megjithatë nuk e dinë.

Le të kemi të gjithë uratën e tij!

# KAPITULLI 1

## Nevoja për drejtues shpirtëror

**Me anë të rrëfimit**

**njeriu çlirohet**

- Jerond, në vitet e para të Krishterimit njerëzit rrëfeheshin publikisht. Të ndihmon diçka e tillë?
- Janë krejtësisht ndryshe vitet e para të krishterimit nga koha e sotme. Diçka e tillë në ditët tona nuk të ndihmon.
- Jerond, përse? Në vitet e para kishin zell më të madh?
- Kishin edhe më tepër zell dhe gjithashtu nuk kishin këto çfarë kanë njerëzit e sotëm. Tani, siç e shikoni, çiftet ndahen shumë shpejtë, nuk janë më si në kohët e vjetra.

Njerëzit janë larguar nga misteri i rrëfimit, prandaj edhe mbyten nga mendimet e këqija dhe nga pasionet. Janë të shumtë ata që vijnë dhe më kërkojnë që ti ndihmoj në një problem që kanë, dhe të cilët as rrëfehen dhe as shkojnë në kishë! «Shkoni në kishë?», i pyes. «Jo» më thonë. «Je rrëfyer ndonjëherë?». «Jo. Kam ardhur që të më bëni mirë». «Në rregull por si? Duhet të pendohesh për gabimet e tua, të rrëfehesh, të shkosh në kishë, të kungohesh, kur të lejojë ati shpirtëror, dhe në vazhdim unë do të lutem që të bëhesh mirë. Harron se ekziston dhe një jetë tjetër dhe duhet të përgatitemi për atje?». «Shikoni at, këto që thoni, kisha, jeta tjetër etj. nuk më interesojnë. Ato janë përralla. Kam shkuar tek magjistarë, tek medium dhe nuk mundën që të më bënin mirë. Kam dëgjuar se ju mund të më bëni mirë». Hajde dhe gjej anën! Ju flet për rrëfim, për jetë të ardhme dhe të thonë «këto janë përralla»,

dhe nga ana tjetër: «Më ndihmo sepse jetoj me ilaçe». Me çfarë mënyre, magjikisht do bëhen mirë?

Dhe ndërsa shikon se problemet e kanë prejardhjen nga mëkatet e tyre, nuk shkojnë tek ati shpirtëror i cili mundet që ti ndihmojë pozitivisht, por përfundojnë të rrëfihen tek psikologët. Ju rrëfejnë historikun e jetës së tyre, këshillohen për problemet e jetës së tyre dhe në momentin që duhet të kalojnë një lumë, i hedhin brenda ose mbyten ose dalin, por ku dalin?!... Ndërsa nëse shkojnë të rrëfihen tek ati shpirtëror, do të kalojnë në bregun tjetër të lumit nga ura dhe me lehtësi sepse me anë të misterit të rrëfimit vepron Hiri i Perëndisë dhe në këtë mënyrë shpëtohen.

- Jerond, disa thonë: «Nuk gjejmë etër të mirë shpirtërorë, prandaj dhe nuk shkojmë të rrëfihemi».
- Këto janë justifikime. Çdo at shpirtëror ka pushtet hyjnor që nga momenti që vendos petrahilin. Kryen misterin e shenjtë, ka Hirin hyjnor dhe kur lexon lutjen e faljes, Perëndia i fal të gjitha mëkatet që rrëfyem me pendim të sinqertë. Se sa do të ndihmohemi nga misteri i rrëfimit varet nga ne. Dikur erdhi në Kalivi dikush që kishte probleme psikologjike, me mendimin se kisha hirin tejshikues dhe do të mundesha ta ndihmoja. «Çfarë parashikon për mua, më thotë?». «Të gjesh një at shpirtëror të rrëfesh që të flesh i qetë dhe të mos marrësh ilaçe, i thashë». «Nuk ka etër të mirë shpirtërorë, më thotë. Më parë kishte por në ditët tona nuk ka». Vijnë me mendimin pozitiv, se do të gjejnë zgjidhje, por nuk i pranojnë ato që iu thua dhe më vjen keq për shpenzimet e rrugës që bëjnë sepse shkojnë dëm.

Gjithashtu shoh dhe një teknikë të re të djallit. Ngulit në mendjen e njerëzve mendimin se, nëse bëjmë një blatim dhe e

përmbushim, nëse shkojmë në ndonjë faltore, mendojnë se janë në rregull nga ana shpirtërore. Dhe me të vërtetë shikon shumë njerëz që shkojnë me llambadha dhe me blatime në manastire që ti vendosin atje, të bëjnë shenjën e kryqit madhërisht, të qajnë pak dhe të mjaftohen me këto. Nuk pendohen, nuk rrëfehen, nuk ndreqen, pikërisht me këto gjëra djalli gëzohet.

- Jerond, një njeri që nuk rrëfehët mund të jetë i qetë në brendësi të shpirtit të tij?
- Si mund të jetë i qetë? Që dikush të ndjejë qetësi duhet të zhduk mbeturinat nga brendësia e tij dhe diçka e tillë bëhet me anë të rrëfimit.

Kur njeriu i hap zemrën atit shpirtëror duke i thënë mëkatet e tij, përulet, dhe kështu hap derën e Qiellit dhe në vazhdim Hiri i Perëndisë vjen i pasur dhe kështu çlirohet.

Para se të rrëfehët dikush në kokën e tij mbizotëron mjergull, shikon trubullt dhe kështu justifikon dhe gabimet e tij. Sepse mendja e tij është e errësuar nga mëkatet dhe nuk shikon qartë. Me rrëfimin fryn një herë «fuuuuu» dhe kështu mjergulla zhduket dhe horizonti pastrohet. Prandaj, të gjithë ata që vijnë të bisedojnë apo të më kërkojnë një këshillë etj., nëse nuk janë rrëfyer kurrë, më përpara i dërgoj që të rrëfehen dhe pastaj të vijnë të bisedojmë. Disa më thonë: «Jerond, ti e di se çfarë duhet të bëj për këtë çështje, më thuaj». «Dhe nëse unë të kuptoj se ç' duhet të bësh, iu them, nuk do të kuptosh se çfarë do të them. Prandaj më parë shko të rrëfehesh dhe më pas eja të bisedojmë». Përse, si mund të bisedosh dhe të kuptohesh me dikë, kur ndodheni në frekuenca të ndryshme?

Me anë të rrëfimit njeriu largon prej shpirtit të tij gjithçka të panevojshme dhe bën fryte shpirtërore. Një ditë punoja kopshtin që të mbillja disa domate. Në atë moment erdhi dikush dhe më

tha: «Çfarë bën Jerond?». «Çfarë të bëj? Iu përgjigja, po rrëfej kopshtin». «Përse ka nevojë edhe kopshti për rrëfim Jerond? Më thotë». «Sigurisht që ka nevojë. Kam kuptuar se kur e rrëfej, nxjerr prej tij gurë, bimë të ndryshme të egra, shkurre etj., vetëm atëherë bëhet pjellor dhe zyrtarisht jep edhe fryte, përndryshe domatet bëhen të zverdhura dhe të dobëta!».

### **Perëndia dëshiron që njeriu të ndreqet me anë të njeriut**

- Jerond, kur përballoj një problem dhe lutem për të, si do të kuptoj se cila është dëshira e Perëndisë?
- Dëshira e Perëndisë nuk gjendet kështu. Më mirë të pyesësh për një problem personal. Mos kërko informacion nga Perëndia, përderisa mund të pyesësh një njeri sepse mund të mashtrohesh. Një herë dikush shkante në kishë, qëndronte përpara ikonastasisit dhe thoshte: «E Tërëshenta ime, ti marr paratë që ndodhen në arkë?». Mendimi i thoshte: «Merri». «Po, do ti mar», thoshte dhe i merrte paratë. «Çfarë po ndodh? thoshte, dikush merr paratë», shkoi që të përgjonte. Ç'të shihte? Pas pak çastesh erdhi i njëjti dhe përsëriti të njëjtat fjalë: «E Tërëshenta ime ti marr paratë nga arka?... Po, do ti marë», tha dhe e kapi kishtari.

Gjithmonë, kur ekziston një njeri shpirtëror, të cilin mund ta pyesësh, duhet të pyesësh. Kur pranë teje nuk gjendet dikush që mund ta pyesësh – p.sh. ndodhesh në shkretëtirë -, por brenda ke etjen e bindjes, atëherë Perëndia bëhet Jerond dhe të ndriçon dhe në vazhdim të njofton. Le të supozojmë p.sh. se nuk mund të gjesh



dikë që të shpjegoj një fragment nga Shkrimi i Shenjtë? Atëherë të ndriçon Perëndia dhe e kupton.

- Jerond, si mund të kuptojë dikush nëse diçka që ndodh gjatë luftës shpirtërore është nga i ligu apo nga pakujdesia?
- Të shkojë të pyes.
- Domethënë vetë nuk mund ta kuptojë?
- Dhe nëse kupton diçka nuk mund nuk mund të jetë i sigurtë. Edhe dikush që ka eksperiencë shkon edhe pyet dikë tjetër. Unë për çdo çështje personale pyes. Zgjidhjen time, dhe zgjidhja më e mirë qoftë, e konsideroj budallallëkun më të madh, kur bëhet fjalë për çështje personale. Dhe nuk shkoj tek dikush që e di se çfarë më qetëson por tek dikush që nuk e di. Siç e dini, një doktor konsultohet edhe me doktorë të tjerë kur nxjerrë një diagnozë të vështirë, aq më tepër për një student! Sado njeri shpirtëror të jesh, dhe sado ti sistemosh vetë me rregull çështjet e tua, nuk mundet të qetësohet sepse Perëndia do që njeriu të ndihmohet prej njeriut dhe të ndreqet prej njeriut. Perëndia i Tërëmirë i rregullon në një formë të tillë që njeriu të përulet. Duhet që të shfaqësh mendimet dhe ngjarjet që kalon tek ati shpirtëror, të këshillohet dhe të mos vendosë vetë për çështjet e vështira dhe as të përballojë i vetëm vështirësitë që kalon në luftën e tij, duke bërë prova me veten e tij, sepse ngasja do ta ngatërrojë dhe do ti shkaktojë probleme. Disa ia arrijnë ti vendosin vetë vetes së tyre rregulla. Këto metoda janë shumë të rrezikshme.

Kush nuk ka at shpirtëror, që të këshillohet gjatë jetës shpirtërore, ngatërrohet, lodhet, vonohet dhe me vështirësi mbërrin në destinacionin e tij. Nëse vendos vetë për problemet e

tij, sado i urtë që të jetë, meqenëse lëviz me vetbindje dhe krenari, mbetet në errësirë. Ndërsa, kushdo që përulet me vetmohim dhe shkon me besim tek ati shpirtëror dhe kërkon mendimin e tij, ndihmohet. Sepse Perëndia me siguri ndriçon atin shpirtëror dhe i jep përgjigjen e saktë. Ja se çfarë ndodh kur dikush vjen me shpresëtari, me mendimin se është i shenjtë, ndërsa unë jam pa vlera, kam vërejtur se ndiej një tjetërsim në shpirt dhe ato çka i them nuk janë fare të miat. Nga kjo kuptoj qartë se ky njeri ka ardhur me shpresëtari, dhe Perëndia, që të mos e padrejtësojë, më jep këtë gjendje të mirë. Në raste të tilla, nëse bëhet fjalë për një çështje serioze, Perëndia të njofton dhe ke mundësi ti thuash se çfarë do të ndodh, kur do të ndodh dhe si ta përballosh.

### **Nevojitet drejtues në jetën shpirtërore**

Gjëja më e rëndësishme në ditët tona është që njerëzit të gjejnë një at shpirtëror, të rrëfehen, ti kenë besim dhe të këshillohen. Nëse vendosin një program me lutje dhe pak studim, shkojnë në kishë, kungohen, atëherë nuk kanë asgjë që të kenë frikë në jetë.

Shpirti duhet të jetë nën vëzhgimin e atit shpirtëror, që të mos gabojë në rrugën e tij. P.sh. mund të të ndihmojë në luftën shpirtërore edhe studimi i librave shpirtërore, por, nëse dikush nuk ka drejtues shpirtëror, mund t'ju japësh shpjegim personal atyre çfarë lexon dhe mund të ngatërrohet. Ashtu si dikush shkon diku me makinë dhe nuk e di mirë rrugën, mund të shikojë hartën por edhe qëndron edhe pyet që të mos marrë rrugë të gabuar. P.sh niset nga Athina që të shkojë në Florinë. Ka me vete një hartë që e shikon vazhdimisht, por gjithashtu pyet dhe në ndonjë dyqan nëse po ecën në rrugën e duhur, nëse rruga është në gjendje të mirë,

sepse ka mundësi të kthejë në një kryqëzim të gabuar dhe të përfundojë në Kavallë apo në ndonjë greminë dhe të rrezikojë të vritet. Natyrisht mund të pyesësh, por në rast se nuk merr rrugën e duhur që të tregojnë dhe në fund përfundon në vend tjetër ose nëse nuk ka kujdes pikat e rrezikshme atëherë do të pësojë ndonjë të keqe. Kushdo pra që i tregon rrugën dhe njëkohësisht i thotë: «kujdes, në filan vend ka një kthesë të rrezikshme, dhe ka një greminë... », me këtë gjë ai që të tregon rrugën merr rrogën e vet. Dua të them se e njëjta gjë duhet të bëhet edhe në jetën shpirtërore. Është e domosdoshme që besimtari të ketë at shpirtëror që ta udhëzojë me këshillat e tij dhe ta ndihmojë me misterin e rrëfimit. Vetëm kështu mund të jetojë jetë shpirtërore ortodokse dhe të jetë i sigurtë se gjendet në rrugën e saktë.

Natyrisht atin shpirtëror duhet që ta zgjedhësh. Nuk do ti besojë shpirtin e tij kujtdo. Ashtu si për shëndetin e trupit kërkon të gjejë doktorë të mirë, ashtu edhe për shëndetin e shpirtit do të kërkojë një at shpirtëror të mirë dhe do të shkojë tek ai, tek doktori i shpirtit, rregullisht.

### **Dërgojini njerëzit tek ati shpirtëror**

- Jerond, shumë herë njerëzit sapo shikojnë rraso fillojnë të na thonë dhimbjet e tyre, madje dhe rrëfehen. Cili duhet të jetë qëndrimi ynë ndaj tyre?
- Që në fillim, kur ju drejtohen për një problem, ti pyesni: «Keni at shpirtëror?». Edhe unë njerëzve që vijnë tek Kalivi të më pyesin për ndonjë çështje iu them: «Unë nuk jam at shpirtëror, shkoni tek ati juaj shpirtëror dhe bëni çfarë t'ju thotë ai». Njerëzit duhet të pendohen dhe të kenë një at shpirtëror të rrëfehen, që të pritët dhe të drejtat e djallit. Të dëgjojë një murgeshë problemin e një gruaje të

vuajtur dhe më pas ta dërgojë tek një at shpirtëror, këtë e kuptoj. Por jo të vazhdojë bisedën me të. Ose nëse një grua nuk është e kënaqur me atin e saj shpirtëror ose nuk ka shkuar asnjëherë të rrëfëhet ose është e dëshpëruar, le ta dëgjojë një herë por përsëri ta dërgojë tek at shpirtëror dhe ti thotë se ajo do të lutet për të.

Jo vetëm që murgesha nuk është e detyruar që ti ndihmojë në këtë formë, dmth. duke dëgjuar vazhdimisht problemet e tyre, dhe mbi të gjitha njerëzit nuk ndihmohen kështu. Sepse njeriu pëson tre tjetërsime: nga vetja e tij, nga të tjerat dhe nga djalli. Vijnë këtu, gjejnë një ngushëllim njerëzor, por sapo largohen nga Manastiri dhe shkojnë në shtëpi, i rikthehen përsëri gjendjes së mëparshme. Të shkojnë tek at shpirtëror edhe burrat edhe gratë. Nuk është e saktë ti thonë problemet e tyre tek murgeshat. Sepse më pas thonë: «ia thashë, dhe tani jam në rregull», qetësojnë gabimisht veten e tyre dhe nuk shkojnë tek at shpirtëror. Kjo është teknikë e djallit në mënyrë që të mos rrëfëhen.

Duhet të kuptoni se cili është misioni juaj si murgesha dhe të mos mendoni të shkoni të bëni gjoja misionarizëm, sepse nuk keni kuptuar misionin murgjëror. Si murgj kemi për detyrë të lutemi për problemet e të tjerëve, por në asnjë mënyrë nuk jemi të detyruar të merremi me problemet e tyre. Këtë gjë e ka për detyrë at shpirtëror dhe është dhe përgjegjës për këtë. Ai mund ti vëzhgojë nga afër dhe të gjejë zgjidhje për problemet e tyre. Dmth nevojitet punë për diçka të tillë. Kjo punë nuk është e murgjëve. Prej nesh le të kërkojnë vetëm lutje. Le të dërgojnë ndonjë letër me emra, të bëjmë ndonjë komboskinë.

## Ati shpirtëror nga afër

Ashtu siç kujdesesh që doktori familjar të jetë pranë tij kështu duhet të kujdeset që edhe ati shpirtëror të jetë pranë tij. Doktori kur ndodhet pranë të sëmurit, mund ta ndihmojë atë shumë herë më mirë se një profesor universiteti – megjithëse mund të mos ketë shumë eksperiencë -, sepse mund ta ndjekë sistematikisht dhe, nëse është e nevojshme, do ta dërgojë tek doktori përkatës specialist. Më bëri përshtypje kur isha në Sanatorium<sup>1</sup> kjo gjë: Shumë pasanikë që kishin tuberkulozë, qëndronin nëpër shtëpitë e tyre dhe shkonin profesor universiteti që të bënin terapinë. Por u duk se terapia nuk kishte asnjë rezultat, sepse nuk mundeshin që ti kontrollonin sistematikisht. Prandaj u detyruan të ndërtonin në Sanatorium reparte të veçanta, që të mjekoheshin atje, në mënyrë që të kontrolloheshin sistematikisht.

Dua të them se, ashtu si doktori kontrollon pacientin nga afër, kur e nënshtron në një terapi të caktuar, shikon nëse ilaçet që i dha kanë efekt apo kanë efekte anësore etj., dhe në raport me këtë ose e shton ose e pakëson dozën e ilaçeve dhe për më tepër, nëse është e nevojshme, mund të ndryshojë dhe terapinë e tij, kështu duhet që edhe ati shpirtëror të ndjekë nga afër shpirtin, sepse me kalimin e kohës shfaq ndryshime dhe reagime të ndryshme, të cilat nuk mund ti ndjekë nga larg që ta ndihmojë rezultativisht. Një herë i thashë një njeriu që kishte një ngasje: «Bëj këtë dhe do të shikosh që do ta kalosh problemin». Më dëgjoji dhe e kaloi problemin. Pas pak kohe kishte një ngasje tjetër krejt të ndryshme, e përballoi me të njëjtën mënyrë dhe u mundua shumë! Mund të dërgonte një njeri ose një letër e bekuara, të më pyeste se çfarë të bënte meqënëse kishte një vështirësi tjetër. Do ti jepja një ilaç tjetër, dmth., një këshillë tjetër. U vështirësua të më pyeste sepse isha

---

<sup>1</sup> Në vitin 1966 Jerondi bëri në Sanatorium një operacion në mushkëri, nga që vuante nga sëmundja e bronkeve.

larg. Prandaj edhe unë nuk e kam zakon që të jap këshilla, nëse nuk e njoh mirë personin dhe të kem një komunikim të ngushtë me të.

### **Ati shpirtëror në familje**

- Jerond, cilat libra mund të ndihmojnë çiftet?
- Ajo çka ndihmon çiftet është që të mos justifikojë secili veten e vet. Nëse justifikojnë veten e tyre, sado të lexojnë çdo libër shpirtëror, nuk ndihmohen. Nëse kanë dëshirë, kanë at shpirtëror dhe i binden, nuk do të kenë probleme. Nuk ka përparim nëse nuk ekziston albitri shpirtëror.

Gjëja më e mira është që çiftet të kenë të njëjtin at shpirtëror dhe jo tjetër at shpirtëror burri dhe tjetër gruaja. Dy drunj, nëse i gdhëndin dy marangozë, secili sipas mënyrës së tij, nuk do të munden kurrë që të përputhen. Ndërsa nëse kanë të njëjtin at shpirtëror, ati shpirtëror gdhënd pjesët që janë të panevojshme – gabimet – e njërit, gdhënd dhe pjesët e panevojshme dhe kështu normalizohen vështirësitë. Por në ditët tona, akoma edhe çiftet që jetojnë me jetë shpirtërore, kanë etër të ndryshëm shpirtërorë. Shumë rrallë kanë që të dy të njëjtin at shpirtëror, prandaj dhe nuk ndihmohen. Kam parasysh shumë çifte që shkonin mirë me njëri-tjetrin por nuk kishin të njëjtin at shpirtëror dhe janë ndarë. Dhe akoma çifte të tjera, që ndërsa nuk shkonin, ngaqë kishin të njëjtë at shpirtëror, jetuan harmonikisht.

Sigurisht, kur një familje ka at shpirtëror të njëjtë është akoma më mirë. Ati shpirtëror do ti dëgjojë të gjithë dhe do të gjej zgjidhjen e duhur për çdo çështje. Një herë do të mendojë nënën dhe herë tjetër babanë, një herë do të flas me fëmijët që të nxjerrë një përfundim nëse nuk nxjerrin përfundime nga ato çka i thonë

prindërit. Në rastin që çifti ka probleme dhe fajin e ka p.sh. bashkëshortja, mund të thërrasë bashkëshortin dhe ta këshillojë se si të sillet ose të kërkojë nga ndonjë i afërm apo i njohur që të ndihmojë në fshehtësi.

### **Ndryshimi i atit shpirtëror**

- Jerond, nëse dikush ndërron atin shpirtëror për një arsye të caktuar, duhet të rrëfëhet përsëri për mëkate që është rrëfyer?
- Mirë është që të informojë atin e ri shpirtëror, ashtu si edhe i sëmuri kur ndryshon doktor i thotë përsëri historikun e tij, në mënyrë që doktori ta ndihmojë më mirë.
- Jerond, nëse dikush deshiron që të ndërrojë at shpirtëror dhe na pyet nëse është e saktë, çfarë duhet t'ju themi?
- Të marrë bekim nga ati i tij shpirtëror. Nuk është mirë të ndërrosh at shpirtëror për gjëra më të vogla. Një ndërtesë nuk do të bëhet kurrë e saktë, nëse ndërrohen vazhdimisht inxhinierët dhe muratorët.

Më parë njerëzit shkonin tek Jerondët që t'ju kërkonin këshilla për çështje që ju interesonte që të gjenin zgjidhje. Sot nuk shkojnë që të kërkojnë këshilla, por që të justifikojnë veten e tyre ose për të thënë që u këshilluan me filan Jerond. «Shkova tek filani dhe filani, pyeta dhe at Paisin për këtë çështje», thotë, ndërkohë që unë mund ta kem qortuar ose mund të ketë ardhur deri tek porta dhe të mos ketë trokitur fare! Kështu përfundojnë të shkojnë nga njëri ati shpirtëror në tjetrin, pa pasur një at shpirtëror të qëndrueshëm dhe kështu ngatërrohen.

Të tjerë përsëri kur bëjnë një gabim dhe nuk shkojnë tia thonë atit të tyre shpirtëror, por shkojnë dhe ia thonë një ati tjetër shpirtëror, që të mos humbin dinjitetin e tyre. Pas pak kohe bëjnë të njëjtin gabim dhe ia thonë një tjetri, dhe kështu me radhë, dhe përfundimisht paraqiten tek ati shpirtëror duke i thënë që e bënë një herë, tek tjetri një herë, dhe kështu vazhdojnë të gabojnë dhe mbeten të pandrequr.

Ekzistojnë dhe disa, kam vënë re, që shmangen të thonë diçka tek ati shpirtëror, megjithëse e dinë që do ti ndihmojë dhe nuk bëhet fjalë që do ta përhap tek të njohurit e tij, që nuk mundet që ti ndihmojë dhe që do ta thotë me siguri edhe tek të tjerë. Më kujtohet, kur akoma isha murg në provë në Manastir<sup>2</sup>, kishte ardhur dikush që të murgjërojë. Qëndroi për një farë kohe dhe pastaj mendote të largohej. Nuk shkoi tek Igumeni i manastirit apo tek ndonjë at shpirtëror por ia tha një punëtori nga Jerisoja, që punonte në manastir. Ndodhesha edhe unë atje pranë kur ia thoshte, po pastroja qep jashtë kuzhinës. Filloi ti rrëfesh me zë të lartë rreth dy metra larg meje. «Jam penduar që u jam bërë murg». «E provova dy vjetë». «Mirë, por përse nuk ike më shpejtë?». «Nuk ika». «U bërë murg pa dëshirën tënde?». «Jo, doja edhe unë». «Dakord por ja the këto Igumenit?». «Jo», iu përgjigj. «Çfarë do të fitosh tani që mi thua mua?», i thotë. I kishte thënë gjithë historinë e tij. E shikoni? Igumenit që duhet tia thoshte, që ta ndihmonte, nuk ia tha dhe shkoi të rrëfehej tek punëtori. Dhe ai në vazhdim do ta thoshte në kafene në Jeriso në fundjavë, që të qeshnin, dhe do ta përhapte në gjithë fshatin. Dhe të thuash se ishte ndonjë i mangët? A e dini se sa gjuhë dinte? Greqishten e vjetër e dinte me përpikmëri.

---

<sup>2</sup> Në Manastirin e Hirshëm Esfigmenu, 1953-1956.



- Jerond, a mundet një laik të pyes për një problem apo për një ngasje një vëlla shpirtëror nëse ati i tij shpirtëror mungon?
- Nuk mund ti telefonojë atit të tij shpirtëror? Vëllai i krishterë disa herë mund ta ndihmojë dhe herë të tjera nuk mundet ose, megjithë predispozitën e tij pozitive, ka mundësi madje dhe ta dëmtojë. Në një rast të nevojshëm me një telefonatë gjërat rregullohen. Dhe në rast se nuk mund të komunikojë me atin shpirtëror dhe bëhet fjalë për diçka serioze dhe emergjente, le të pyes një at tjetër shpirtëror. Mirë do të ishte që ta ketë pyetur që më parë se tek cili at shpirtëror mund të këshillohet në rast të tillë, në mënyrë që të shkojë tek dikush që ka të njëjtën frymë. Sepse çdo inxhinier ka planin e tij personal. Mund të jenë pozitive që të dyja planet por sido që të jetë janë të ndryshme.

## KAPITULLI 2

### Për një rrëfim të saktë

#### Ta lidhim plagën tonë

- Jerond, po kur gjatë luftës sime shpirtërore më hyn frika?
- Mos ki frikë. Luftë është dhe normalisht do kemi edhe plagosje. Këto plagë me anë të rrëfimit shërohen. Siç e dini, ushtarët në luftë, kur plagosen në një betejë, shkojnë menjëherë tek doktori, lidhin plagën dhe vazhdojnë të luftojnë me sedër. Gjithashtu përfitojnë edhe përvojë nga plagosjet dhe ruhen me më shumë kujdes që të mos plagosen përsëri. Kështu edhe ne, kur plagosemi gjatë luftës sonë shpirtërore, nuk duhet të frikësohemi, por duhet të vrapojmë tek doktori – tek ati shpirtëror -, ti tregojmë plagën tonë, të shërohemi shpirtërisht, dhe të vazhdojmë përsëri «luftën e mirë»<sup>3</sup>. Nuk është mirë që të mos kërkojmë armiqtë e tmerrshëm të shpirtit, pasionet, dhe të mos përpiqemi që ti zhdukim.
- Jerond, disa nuk shkojnë të rrëfohen nga sedra. «Përderisa mund të bëj përsëri të njëjtin gabim, thonë, përse të shkoj të rrëfhem? Që të tallem me priftin?».
- Kjo nuk është e drejtë! Është sikur të thotë një ushtar kur plagoset: «Përderisa lufta nuk ka mbaruar dhe mund të plagosem përsëri, përse duhet ta lidh plagën?». Por nëse nuk e lidh do të vdesë nga hemoragjia. Mund të mos shkojë nga sedra që të rrëfohen por në fund do të shkatërrohen. Siç e dini djalli shfrytëzon dhe hiret. Nëse

---

<sup>3</sup> 1 Tim. 6, 12.

nuk pastrojmë me anë të rrëfimit shpirtin tonë, kur biem dhe mëkatojmë, me mendimin se do të mëkatojmë përsëri, iu shtojmë papastërti plagëve të vjetra dhe më pas do jetë shumë e vështirë që të pastrohen.

### **Nevoja për rrëfim**

- Jerond, Oshënar Mark Asketi thotë: «Ai që rrëfëhet me vetëdije tek Perëndia nuk rrëfëhet duke i numëruar gabimet e tij, por me durimin e dhimbjeve që u largohen<sup>4</sup>. Çfarë do të thotë me këtë?»
- Duhet që të bëhen dhe njëra edhe tjetra. Besimtari rrëfëhet tek ati shpirtëror, gjithashtu rrëfëhet edhe para lutjes tek Perëndia më përulësi, duke zhveshur veten e vet: «Perëndia im, gabova, jam kështu dhe kështu». Njëkohësisht pranon edhe dhimbjet që veprojnë si ilaç. Shenjtori nuk thotë që të mos bësh rrëfimin e parë apo të dytë, por vetëm të durosh trishtimet e dhimbjet. çfarë do të thotë «rrëfëhem?». Nuk do të thotë «Pohoj jashtë vetes ato çka kam Brenda shpirtit»? Nëse brenda teje qëndron pushtetshëm psalmi «lavdëroni Zotin»<sup>5</sup>, dmth. lavdëron Perëndinë. Nëse ke gjëra negative, rrëfen mëkatet e tua.
- Jerond, kur dikush shkon për herë të parë të rrëfëhet duhet ti thotë atit shpirtëror për gjithë jetën e tij të mëparshme?
- Herën e parë do bëjë një rrëfim të përgjithshëm. Ashtu si edhe i sëmuri, kur futet në spital, jep historikun e tij, p.sh. thotë: «kisha një problem me mushkëritë por tani e kam kaluar, jam operuar një herë me narkozë të të gjithë trupit apo me narkozë vendore etj.», kështu edhe kur dikush

---

<sup>4</sup> Shih Oshënar Mark Asketi, *Filokalia e Etërve Niptikë, vëll 1, faq. 120.*

<sup>5</sup> Shih. Psalm. 106, 1.

rrëfëhet për herë të parë le të përpiqet ti thotë atit shpirtëror hollësi nga jeta e tij, dhe ai do të gjejë plagën që ta shërojë. Shpesh herë, një goditjeje që nuk i jep rëndësi, më vonë shfaqen pasojat. Sigurisht, kur do të shkojë për herë të parë tek ati shpirtëror, do ti thotë, le të supozojmë, njëqind mëkate. Herën e dytë do të ketë njëqind e dhjetë, sepse do ta luftojë djalli më shumë, ngaqë u rrëfye dhe i prishi punë. Herën e tretë njëqind e pesdhjetë, por më pas numri do të pakësohet vazhdimisht, deri sa do të shkojë dhe do të ketë gjithnjë e më pak mëkate.

### **Rrëfimi i saktë**

- Përse disa herë, ndërsa na kontrollon ndërgjegja, nuk bëjmë përpjekjen e duhur që të ndreqemi?
- Diçka e tillë mund të ndodhë dhe nga ndonjë goditje shpirtërore. Nëse dikush është i frikësuar nga një ngasje, do që të luftojë, por nuk ka dëshirë, nuk ka fuqi shpirtërore. Atëherë duhet të rregullohet shpirtërisht duke u rrëfyer. Me anë të rrëfimit ngushëllohet, bindet dhe gjen përsëri me Hirin e Perëndisë kurajon për përpjekje. Nëse nuk sistemohet shpirtërisht, mund ti vijë tjetër ngasje, kështu që, ashtu siç është i dëshpëruar, goditet akoma më shumë, e mbysin mendimet, humbet shpresën dhe në vazhdim nuk mundet të luftojë.
- Dhe nëse kjo ndodh shpesh?
- Nëse ndodh shpesh, duhet që të sistemohet shpesh, tia hap zemrën atit shpirtëror që të marrë kurajo. Kur sistemohet, duhet ta nder motorrin, të luftojë me sedër dhe intensivisht, që ta bëjë zap të ligun.
- Jerond, kur nuk e shikoj të nevojshme për tu rrëfyer, kush e ka fajin?

- Mos ndoshta nuk e kontrollon veten tënde? Rrëfimi është mister. Thjeshtë të shkosh të thuash mëkatet e tua. Përse, çfarë mendon? Këmbëngul pak! Egoizëm nuk ke? Pse unë çfarë shkoj dhe rrëfej? «U nxeha, gjykova...» dhe ati shpirtëror më lexon lutjen e faljes. Por kanë edhe mëkatet e vogla peshë. Kur shkoja tek At Tihoni<sup>6</sup> që të rrëfhem, nuk kisha diçka të rëndësishme ti thosha dhe më thoshte: «Rërë, biri im, rërë!»! Mëkatet e vogla mblidhen dhe bëjnë një pìrg të madh rëre, por i cili pìrg është shumë më i rëndë se një gur i madh. Dikush që ka bërë një mëkat të madh, e mendon vazhdimisht, pendohet dhe përulet. Ti ke shumë mëkate të vogla. Por nëse analizon kushtet me të cilat ti u rrite dhe kushtet me të cilat u rrit dikush tjetër, do të kuptosh se je më i keq se ai. Gjithashtu të përpiqesh që gjatë rrëfimit të jesh konkretë. Nuk është e mjaftueshme që të thuash p.sh. «Kam smirë, kam nerva etj.», por duhet të thotë ngjarjet konkrete që lidhen me to në mënyrë që të ndihmohet. Kur bëhet fjalë për diçka të madhe, si përshembull dinakëria, duhet të thotë se si mendoi dhe se si veproi sepse përndryshe tall Krishtin. Nëse nuk pohon të vërtetën tek ati shpirtëror, nuk i zbulon gabimin, që të mund ta ndihmojë, dëmtohet, ashtu si edhe i sëmuri dëmton shëndetin e tij, kur fsheh problemin e tij nga doktori. Ndërsa kur shfaq veten e tij ashtu siç është, atëherë ati shpirtëror mund ta njoh më mirë dhe ta ndihmojë më mirë.

Në rastin që dikush padrejtëson ose plagos me sjelljen e tij dikë tjetër, më parë duhet të shkojë ti kërkojë falje me përulësi, të pajtohet me të, dhe më pas të shkojë të rrëfejë gabimin tek ati shpirtëror, që të marrë faljen. Kështu vjen edhe Hiri i Perëndisë.

---

<sup>6</sup> Shih Jerond Paisi nga Mali i Shenjtë, Etër nga Mali i Shenjtë, faq. 15-40.

Nëse thjeshtë rrëfen gabimin e tij tek ati shpirtëror, pa i kërkuar më parë falje njeriut që plagosi, nuk mundet të qetësohet shpirti i tij, sepse nuk përulet. Vetëm nëse njeriu që plagosi nuk jeton ose nuk mund ta gjejë se ku ndodhet sepse ndryshoi banesë dhe nuk e di adresën e tij, që ti kërkojë, qoftë edhe me shkrim falje, por ama ka dëshirë që ta bëjë, atëherë Perëndia e fal sepse shikon sepse e dëshiron me të vërtetë këtë gjë.

- Jerond, nëse kërkojmë falje dhe nuk na fal?
- Atëherë të lutemi që Perëndia të zbusë zemrën e tij. Por ka mundësi që Perëndia të mos e zbusë zemrën e tij, sepse nëse na fal, mund të bëjmë përsëri të njëjtin gabim.
- Jerond, nëse bën një mëkat shumë serioz, mundet që të mos e rrëfeje menjëherë?
- Përse të mos e rrëfejë? Të thartohet? Sa më tepër mban diçka të prishur aq më tepër priset. Përse të lërë të kalojnë një apo dy muaj, që të shkojë ta rrëfeje tek ati shpirtëror? Le të shkojë sa më shpejtë. Nëse ka një plagë të hapur, do pres të kaloj një muaj, që ta shërojë? As mos të pres që ati shpirtëror të ketë më tepër kohë dhe lehtësi. Një gabim të tillë e thotë menjëherë tak-tak, dhe kur ati shpirtëror të ketë më tepër kohë, le të shkojë të bisedojë etj.

Nuk duhet shumë kohë, që të kem një ikonë të vetes time. Kur ndërgjegja funksionon në rregull, mundesh që të kesh një ikonë të gjendjes tënde. Në rastin që brenda tij është i ngatërruar, mund të përshkruajë shumë pa dhënë një figurë të qartë të gjendjes së tij. Shoh shumë njerëz që bëjnë raporte në fletore të shumta, njëzet-trishjetë faqe raporte me shkronja të vogla, dhe disa faqe pas me postshënime... Të gjitha këto që shkruajnë, do të kishin mundësi ti përmbledhnin në një faqe.

## Ato që na lehtësojnë në rrëfimin tonë

### rëndojnë ndërgjegjen

- Jerond, nëse gjatë rrëfimit nuk ndjen dhimbjen që ndiente kur bëri mëkatin, do të thotë që nuk është penduar me të vërtetë?
- Nëse ka kaluar kohë që prej momentit që ka bërë mëkatin, plaga bëhet më mirë, prandaj dhe nuk ndien të njëjtën dhimbje. Ajo çka duhet të ketë kujdes është që të mos justifikojë veten gjatë rrëfimit. Unë, kur shkoj të rrëfehem dhe them p.sh. «u nevríkosa» - megjithëse mund të jepja dhe një pëllëmbë -, nuk e përmend këtë gjë, në mënyrë që ati shpirtëror të mos më lehtësojë. Kush rrëfëhet dhe justifikon veten e tij, nuk ka qetësi shpirtërore, sado i pandërgjegjshëm qoftë. Justifikimet dhe lehtësitë që përdor gjatë rrëfimit i bëhen peshë në ndërgjegje. Ndërsa kushdo që e tepron me gabimet e tij, sepse ka ndërgjegje të ndjeshme, dhe pranon dhe një “dënim” më të madh nga ati i tij shpirtëror, ndien ngazëllim të pashprehshëm. Ka njerëz të cilët kur vjedhin një kokërr rrush p.sh., ndihen se kanë vjedhur kosha të tërë me rrush dhe mendojnë vazhdimisht gabimin e tyre. Nuk flenë për gjithë natën derisa ta rrëfejnë. Ka edhe të tjerë të cilët ndërsa kanë vjedhur kosha të tërë me rrush, justifikojnë veten e tyre duke thënë se vodhën vetëm një vesh rrush. Ata që jo vetëm nuk e justifikojnë gabimin e tyre por madje zmadhojnë gabimin më të vogël dhe mërziten e vuajnë shumë për këtë parregullsi që bëjnë, e dini se çfarë

ngushëllimi shpirtëror që ndiejnë? Këtu shikon drejtësinë hyjnore, se si Perëndia i Mirë shpërblen.

Kam vënë re se ata që zbulojnë gabimet e tyre me përlulësi tek ati shpirtëror dhe turpërohen, shkëlqejnë, sepse pranojnë Hirin e Perëndisë. Një ushtarak i çmobilizuar më tregoi me shumë dhimbje se çfarë kishte bërë kur ishte tetë vjeç. Kishte marrë një top nga një fëmijë për një natë – ditën tjetër ia dha – dhe qante, sepse e mërzi. Kur u lirua, kërkoi të gjithë ata që kishte mërziur dhe trishtuar, kur ishte akoma në detyrë – megjithëse kryente detyrat e postit të tij -, dhe iu kërkoi falje! Më bëri përshtypje! Ia ngarkonte të gjitha vetes së tij. Tani jeton në një fshat dhe të gjitha paratë i jep lëmshë. Kujdeset dhe për nënën e tij të moshuar, e cila për nëntëdhjetë e pesë vjetë dergjet në krevat, meqenëse shikon trupin e saj, kur përkujdeset, e mundon mendimi. «Nëse Hami që pa lakuriqësinë e atit të tij u dënua<sup>7</sup>, thotë, atëherë unë...». Qante vazhdimisht. Fytyra e tij ishte ndryshuar. Sa shumë gjëra mësova nga vuajtjet e tij!

- Jerond, mundet që duke zmadhuar gabimet dikush të tregojë punën e tij të hollësishme?
- Ajo është tjetër gjë, atëherë krenohet nga përlulësia.

### **Pas rrëfimit**

- Jerond, pas pendimit justifikohet të ndiesh barrë?
- Përse të ndihesh i rënduar? Me një rrëfim të saktë fshihen gjithë të kaluarat. Hapen defter të rinj. Vjen Hiri i Perëndisë dhe njeriu ndryshon rrënjësisht. Humbet tronditja, egërsia, ankthi dhe vjen paqja, qetësia. Kjo është kaq e ndjeshme nga jashtë, sa që u them disave të fotografohen përpara dhe pas rrëfimit, që të kuptojnë vetë ndryshimin sepse në fytyrë pikturohet gjendja e

---

<sup>7</sup> Shih Gjen. 9, 20-27.



brendshme shpirtërore. Misteret e kishës bëjnë mrekulli. Sa më shumë i afrosh Perëndinjeriut Jisu Krisht, hyjnizohesh, dhe është logjike të shkëlqesh nga Hiri hyjnor.

- Jerond, kjo do të thotë që pas një rrëfimi të sinqertë ndien menjëherë gëzim?
- Jo gjithmonë. Mund të mos ndiesh menjëherë gëzim, por ngadalë-ngadalë lind brenda teje gëzimi. Pas rrëfimit duhet të bësh një rivlerësim me vetëdije. Të ndihesh ashtu siç ndihet dikush që ka një borxh të madh që i falet, dhe nga sedra ndien një mirënjohje të madhe dhe detyrim ndaj bamirësit të tij. Të falenderosh Perëndinë por njëkohësisht të jetosh atë që thotë psalmisti: « Ja, unë jam mbraujtur në paudhësi, dhe nëna ime më ka lindur në mëkat»<sup>8</sup>, që përqëndrimi të mos largohet dhe bën përseri të njëjtat gabime.
- Jerond, lexova diku se demonët do të na mundojnë në jetën tjetër qoftë edhe për një mëkat që nuk rrëfyem.
- Shiko, kur njeriu pendohet dhe i thotë atit shpirtëror gjithçka që mban mend, pa u munduar që të fsheh diçka, gjithçka ka mbaruar, demonët nuk kanë asnjë pushtet mbi të. Por në rast se me dijeninë e tij disa mëkate nuk i rrëfen, do të mundohet në jetën tjetër për ato.
- Jerond, nëse rrëfesh për mëkatet e rinisë dhe kur i mendon ato të mundojnë akoma, është përballim si saktë?
- Nëse ndien vuajtje në shpirt për mëkatet e rinisë dhe i rrëfen, nuk ka arsye të vuajë sepse Perëndia që nga momenti që i rrëfeu ia fali mëkatet. Që nga ky çast nuk duhet të ngacmojë të shkuarën e tij, sidomos kur bëhet fjalë për mëkate trupore, sepse mund të dëmtohet. Përshembull gjatë luftës bie një bombë pranë një ushtari,

---

<sup>8</sup> Psalm. 50, 5.

por e shpëton Perëndia dhe nuk shpërthen. Kur lufta mbaroi ushtari shkon dhe gjen bombën që nuk shpërtheu dhe fillon ta shikojë, përfundimisht shpërthen duke e vrarë në kohë paqeje.

### **Besnikëria ndaj atit shpirtëror**

- Jerond, nëse dikush mërzhitet shumë sepse e qortoi ati shpirtëror për një gabim, dhe bie në depresion, kjo gjë a fsheh brenda saj egoizëm?
- Sigurisht, brenda tij ty reagim ka edhe egoizëm. Nëse mërzhitet më Zotin atëherë do të gjej ngushëllim, do të ketë edhe përparim sepse do të përpiqet që të mos e bëjë përsëri. Duhet që atit shpirtëror ti thotë vështirësitë, mendimet, rëniet dhe të pranojë me gëzim sjelljen e butë por edhe të ashpër të atit shpirtëror, sepse gjithçka që bëhet, bëhet me dashuri dhe interes për përparimin e shpirtit të tij.
- Jerond, po nëse nuk e pranoj qortimin apo vërejtjen?
- Nëse nuk e pranon do të mbetesh e pandreqshme. Të gjithë ata që nuk pranojnë qortime as nga njerëzit që i duan, ngelen drunj të shtrembër dhe vetshkatërrohen shpirtërisht. Ashtu si edhe dërrasat që nuk mund të kalojnë në planin e marangozit, që në vazhdim të bëhen mobilje, përfundojnë në betonë dhe nëpër shkallët dhe hidhen dhe bëhen gjithë llaç, derisa arrijnë në zjarr, kështu edhe ata në fund shkatërrohen.
- Jerond, nëse nuk bie dakord me një çështje me atin shpirtëror, çfarë duhet të bëjë?
- Ti thotë me thjeshtësi dhe përlësi mendimin e tij. Sigurisht duhet shumë kujdes kur zgjedhim atin

shpirtëror, që të kesh mundësi të kesh besim dhe të pranosh udhëzimin e tij.

- Jerond, ia vlen të këmbngulësh në mendimin tënd kur shikon se ati shpirtëror mbështet diçka të ndryshme?
- Jo, sepse nuk e di se çfarë fshihet pas asaj që ai mendon se nuk është e saktë. Përshembull që të kuptojë dikush se çfarë fshihet pas një veprë të atit shpirtëror, ati shpirtëror ndoshta duhet ti thotë rrëfimin e dikujt tjetër. A lejohet që të thotë rrëfimin e dikujt tjetër? Sigurisht që jo. Le të supozojmë se ka lënë takim të takojë atin shpirtëror në një orë të caktuar, por në atë moment shkon dhe dikush tjetër që ka mendim që të vras veten dhe ati shpirtëror takon më parë atë. Kështu që mendon: «Pranoi më parë atë, ndërsa mua nuk më jep rëndësi». Por si ti thotë ati shpirtëror se ai mendon të vras veten? Nëse i shpjegon atëherë shkatërron personin tjetër. Ndërsa nëse ai skandaliset dhe var turinjtë, nuk është ndonjë e keqe e madhe. Një herë kështu u skandalizuan disa që kishin ardhur tek Kalivi. Bëhesh fjalë për dikë që e kishin bindur me shumë vështirësi të afërmit e tij të vinte të bisedonte dhe e prita me gëzim të madh. E përqafova, i dhashë një komboskin dhe ikona. Të tjerët u keqkuptuan. «Jerondi neve nuk na dha rëndësi fare». Ai i shkreti ishte plangprishës dhe dija me hollësi për jetën e tij. Kur u largua nga Kalivi ishte tjetër njeri. Një mijë herë le të skandalizohen të tjerët. Nuk ka mundësi që të qetësosh njërin me shpjegime dhe tjetrin ta shkatërrosh.

**Komunikimi i saktë me atin shpirtëror**

Një njeri shpirtëror kur do që të ndihmojë dikë, përpiqet që ta lidh me Krishtin dhe jo me veten e tij. Kur arrin ta lidh me Krishtin dhe ai përpiqet duke pasur si shembull Krishtin atëherë gëzohet. Në këtë pikë edhe njëri edhe tjetri merr shpërblimin e tij dhe gjërat ecin normalisht. Në rastin që njeriu përpiqet që të kënaqë atë që përpiqet që ta lidh me Krishtin, dmth. nëse një veprim i tij do të mërzis apo do të kënaq atë, dhe nuk kupton se Krishti e shikon këtë veprim, atëherë as njeriun që e ndihmon nuk kënaq por as edhe Krishtin, mbi të gjitha as ai vetë nuk ka dobi sepse nuk pranon ndihmë hyjnore. Dmth. as ati shpirtëror as edhe Krishti nuk gëzohen për këtë që bën, por as edhe ai vetë nuk ndihmohet, të përballojë një vështirësi. Le të supozojmë se një motër shpirtërore psal dhe mendon: «Vallë a psal bukur? Do ti bëhet qejfi Igumenes?». Në këtë rast ajo nuk ka dobi, nuk ndihmohet. Ndërsa nëse psal për Krishtin, gjërat ecin rregullisht, do të psal edhe mirë por edhe do të kënaq edhe Igumenen.

- Jerond, nëse dikush nuk kupton saktë atë çka i tha ati shpirtëror, ka faj?
- Shiko, nëse nuk kuptoi sepse kishte një dëshirë dhe mendja e tij ndodhej atje, ka faj. Disa njerëz dëshirën e tyre e bëjnë dëshirë të Perëndisë. Përshembull ndërkohë që pyet dikush atin shpirtëror për një problem dhe ka në mendje zgjidhjen që deshiron dhe e qetëson. Ati shpirtëror i thotë atë që duhet të bëjë dhe konstaton se është ajo që donte dhe ai, dhe e bën me dëshirë duke menduar se në këtë mënyrë bën bindje. Dhe nëse më vonë ati shpirtëror i thotë «Përse veprove kështu?», i përgjigjet: «kështu nuk më the të veprojt?».

Duhet të kemi parasysh se disa herë ato që na thotë ati shpirtëror nuk duhet ti marrim fjalë për fjalë. Mundet të jetë mënyrë të shprehuri. Do t'ju them një shembull që të kuptoni. Një

profesore dyzet e pesë vjeçare e cila kishte edhe fëmijë, ishte dhënë trupërisht me një nxënësin e saj gjashtëmbëdhjetë vjeçar. Nxënësi në vazhdim iku nga shtëpia e tij dhe bashkëjetonte me mësuesen. Kur babai i tij erdhi tek Kalivi dhe më tregoi këtë problem, të veprojë ashtu si ti thotë ati i tij shpirtëror, i thashë. Shkoi tek ati shpirtëror dhe erdhi përsëri tek unë. Atë ditë kishin ardhur të më vizitonin disa Eksarkë nga Patriarkana<sup>9</sup>, dhe nuk kisha kohë të bisedoja me të dhe i thashë: «Të veprosh ashtu siç të tha ati yt shpirtëror». Ai nuk u largua – dhe fatmirësisht që nuk iku dhe këmbnguli e më priti. Sapo gjeta pak kohë e takova për pak dhe më tha: «Jerond, vendosa që ta vras atë grua sepse kështu më tha ati shpirtëror». «Prit, i thashë, çfarë të tha konkretisht ati yt shpirtëror?». «Më tha: “Ajo grua është për tu vlarë”». Ati shpirtëror e kishte thënë si shprehje, «ajo grua është për tu vlarë», dhe jo që ta vriste! Që atëherë nuk i them asnjërit: «të veprosh ashtu siç të tha ati shpirtëror», por pyes çfarë të tha ati shpirtëror...

- Jerond, mund të kërkosh ndihmë prej atit shpirtëror dhe njëkohësisht të propozosh dhe zgjidhjen e problemit që ke?
- Nëse e bën këtë, atëherë çfarë ndihme kërkon? Është tjetër gjë ti thuash atit shpirtëror se çfarë mendon se mund ta ndihmojë – kjo është e detyrueshme – dhe është tjetër gjë të këmbngulë që mendimi i tij është i saktë. Në këtë rast njeriu nuk ecën përpara. Është sikur të shkojë tek doktori dhe ti thotë: «Më jep këtë ilaç». I sëmuri duhet ta dëgjojë doktorin, nuk do ti tregojë se çfarë ilaçi duhet të marrë. Këtu nuk bëhet fjalë nëse ke oreks apo jo, ashtu siç ndodh me ushqimet dhe ëmbëlsirat, që të thuash: «Dua bakllava ose dua kadaif». Doktori i jep ilaçet në varësi me sëmundjen që ka secili.

---

<sup>9</sup> Përfaqësues të Patriarkanës.

## KAPITULLI 3

### Doktori shpirtëror

#### Nevoja për etër të mirë shpirtëror

Njerëzit e sotëm janë të lodhur, të trullësuar dhe të errësuar nga mëkati dhe egoizmi. Prandaj është nevoja për etër shpirtërorë të mirë dhe me përvojë, që do t'ju afrohen njerëzve me thjeshtësi dhe me dashuri të vërtetë dhe ti udhëzojnë me dallim që të paqësohen. Nëse nuk do të kemi etër shpirtërorë atëherë do të zbrazen kishat dhe do të mbushen psikiatritë, burgjet dhe spitalet. Njerëzit duhet të kuptojnë se vuajnë, se janë larg Perëndisë, të pendohen dhe të rrëfejnë me përgjësi mëkatet e tyre.

Puna e atit shpirtëror është punë e brendshme. Nuk ekziston doktor më i lartë se sa ati shpirtëror dhe me një përvojë që frymëzon besim me shenjtërinë e tij, dhe largon prej shpirtave të brishtë të Perëndisë djallin dhe shëron shpirta dhe trupa pa ilaçe, me Hirin e Perëndisë.

Ati shpirtëror, kur ka ndriçim hyjnor, frymë Perëndie, kupton dhe dallon gjendje të ndryshme, dhe ka mundësi që t'ju japë udhëzime të sakta shpirtave. Mirë do ishte që të mos merrej me gjëra të tjera, në mënyrë që të mundte të dispononte kohën e duhur për çdo njeri dhe të kryente punën e tij siç duhet. Përndryshe do të pësoj atë çka pëson edhe një kirurg i cili kur çdo ditë bën operacione të shumta, lodhet dhe normalisht nuk do të ketë njëjtat rezultate në punën. Por edhe ai që rrëfehët nuk duhet të harxhojë kohën e atit shpirtëror për çështje që mund të pyes të tjerë, p.sh. cilën shtëpi të marrë me qera apo në cilin kurs ti dërgojë fëmijët etj..

Gjatë rrëfimit provohet edhe ai që rrëfëhet por edhe ati shpirtëror. Këtu duhet të përmendim se liria shpirtërore ndihmon në masë të madhe në drejtimin shpirtëror të shpirtit. Dmth. ati shpirtëror të mos ndjekë një rrugë tjetër që ia imponojnë të tjerë, por të shikojë se çfarë thonë etërit e kishës dhe të veproj për çdo njeri sipas karakterit të tij, me mëkatin por edhe me pendimin. Por disa herë konstatoj se nuk janë të sinqertë përshembull disa njerëz që kanë një farë përgjegjësie për të njohurit e tyre nuk ju thonë një fjalë që ti problematizojnë sadopak përshembull nëse bën gabim dhe ngatërrohet me magjistarë, me njerëz të mashtruar etj., duhet të marrin një pozicion, që të mos kenë probleme me ta. Dmth, që të mos prishin lidhjet që kanë me, duke ju thënë fjalët e duhura për shëndetin e shpirtit. Por me këtë gjë nuk i ndihmojnë por i lënë në mëshirë të fatit.

### **Dallimi dhe përvoja e atit shpirtëror**

- Jerond, në epokën tonë, me kaq shumë mëkate që ka në botë, disa herë ati shpirtëror vendoset në pozitë të vështirë?
- Po, është e vështirë. Prandaj dhe në fillim puna e atit shpirtëror është të përpiket të korrigjojë mëkatet më serioze, derisa të ikin mëkatet e shumta nga krijesat e Perëndisë dhe të bëhen më të durueshme. Të sillen me butësi, por njëkohësisht me një mënyrë të tillë që ti udhëzojë njerëzit kështu që të kuptojnë gabimet dhe të kërkojnë prej Perëndisë falje. Është e domosdoshme që ti theksojë atij që rrëfëhet se duhet të pendohet, duhet të ndryshojë jetë që të marrë mëshirën e Perëndisë. Gjithashtu diçka tjetër që ndihmon në këtë fazë është komunikimi me njerëzit, domethënë t'ju flas me dashuri

për dashurinë e madhe të Perëndisë, në mënyrë që të problematizohen, të kuptojnë gabimet e tyre dhe kështu të ndryshojnë zakone.

Një at i ri shpirtëror derisa të fitojë përvojë, mirë është që të ndihmojë në problemet më të lehta. Sepse një rast i vështirë mund të pengojë zhvillimin e tij shpirtëror me sabotazhet dhe vështirësitë që do të përballojë dhe do ti harxhojë të gjithë kohën. Nëse nuk bën kujdes, me predispozitën e tij positive do ti japë gjithnjë rëndësi skenave që do ti bëjë një njeri i tillë, do të harxhojë pa asnjë qëllim fuqitë e tij dhe do të mundohet. Kur do të fitojë përvojë, do të kuptojë, se kur duhet ti japë rëndësi një çështjeje dhe kur duhet të mos i japë rëndësi. Përshembull tani kur më vijne letrat iu hedh një sy dhe nëse diçka është serioze asaj i jap rëndësi. Shpesh herë janë dhe nga i ligu. Mund të ndodh që dikush të të thotë: «dy minuta, dua të të them diçka këtu tek porta shpejtë e shpejtë» dhe të mban për një orë të tërë. Të të godas era dhe të djersitesh e të jesh shumë i lodhur megjithatë nuk e kuptojnë dhe vazhdojnë të thonë historitë e tyre pa menduar aspak për ty. Diçka e tillë nga Perëndia është? Është normale që më pas të sëmuresh dhe nuk mund të lutesh as për të tjerët dhe as për veten tënde, për ditë të tëra je i këputur. Dhe nëse vjen dikush që ka nevojë me të vërtetë për ndihmë dhe nuk mundesh ta ndihmosh.

Gjithashtu kini parasysh se ata që kanë një problem serioz, nuk mjafton ti dëgjosh, të shohësh se kanë një dhimbje dhe t'ju thuash: «Merre një aspirinë». «Vetëm një minutë do të bezdis, thonë disa, sepse më ikën makina», dhe ndërkohë të thonë një çështje serioze. Sikur dikush të kishte kancer dhe ti thoshte doktorit: «Bëj një operacion, sepse duhet të iki për pak, më ikën aeroplani!». Çdo problem do kohën e duhur. Të shikosh ku fillon, çfarë pasojash ka etj. Nuk mund të gjesh zgjidhje të çastit për një çështje serioze. Një murg fillestar mu afrua në Litaninë që bëjnë në



javën e Ndrithshme në Malin e Shenjtë, në momentin që filluam ti ngjiteshim një maloreje dëshironte që ti thoja për lutjen mendore. Sado që kishte ardhur shumë herë tek Kalivi asnjëherë nuk më kishte pyetur, dhe atje, momentin që po ngjiteshim, ishte frymëzuar të më pyeste për një çështje kaq të thellë! Një çështje kaq serioze dhe e thellë nuk diskutohet as në këmbë dhe as në malore...

### **Ati shpirtëror përcakton**

#### **se kur besimtari duhet të kungohet**

- Jerond, Apostull Pavli shkruan: «Ai që ha dhe pi padenjësisht, ha edhe pi një dënim për veten e tij»<sup>10</sup>. Kur kungohet dikush «padenjësisht»?
- Si rregull duhet që të shkojmë në Kungatën hyjnore duke pasur parasysh padenjësinë tonë. Krishti kërkon prej nesh pendimin e thellë dhe përrulësinë. Nëse ekziston diçka që shqetëson ndërgjegjen tonë duhet që ta ndreqim këtë problem. P.sh. nëse zihemi me dikë, duhet që më parë të pajtohemi me të dhe më pas të shkojmë të kungohemi.
- Jerond, disa megjithëse kanë bekim nga ati i tyre shpirtëror ngurrojnë të kungohen.
- Nuk mundet që dikush të vendos vetë nëse do të kungohet apo jo. Nëse dikush vendos vetë se kur do të kungohet dhe kur jo, do ta shfrytëzojë djalli dhe do ti hap probleme. Shumë herë mendojmë se jemi të denjë dhe në të vërtetë nuk jemi, dhe disa herë të tjera ndërsa në bazë të ligjeve nuk jemi të denjë, por sipas mësimave të Etërve të Shenjtë është e nevojshme Kungata Hyjnore dhe ngushëllimi hyjnor, sepse nga pendimi i thellë mund të

---

<sup>10</sup> 1 Korint. 11, 29.

vijë në të djathtën tonë armiku dhe të na hedhë në depresion.

- Jerond, sa shpesh duhet të kungohemi?
- Se sa herë duhet që dikush të kungohet dhe se çfarë kreshme duhet të mbajë përpara Kungatës hyjnore, nuk mund të futen në kallupe. Diçka të tillë do ta vendosi ati shpirtëror se kur do të kungohet dhe sipas mundësisë dhe rezistencës së tij, se sa kreshmë do të mbajë. Paralelisht do ta drejtojë dhe në kreshmën shpirtërore, distancimin nga pasionet, duke rregulluar dhe të sipas rezistencës së secilit me ndjeshmërinë shpirtërore, dmth. në varësi me ndjeshmërinë ndaj gabimeve të tij, dhe duke pasur parasysh të keqen që mund të bëj armiku duke luftuar një shpirt të ndjeshëm, që ta hedhë në depresion. Përshembull për mëkatet trupore, për të cilat zakonisht ndalohet të kungohesh për dyzetë ditë, përsëri djalli mund ta godasë në ditën e tridhjetë e pestë dhe, nëse i jepet përsëri një rregull dyzetë ditor, djalli do ta ndjekë shpirtin këmba këmbës, kështu që do të humbas ndienjat dhe do të dëshpërohet. Në raste të tilla ati shpirtëror, pas rregullit të parë, të thotë: «kij kujdes për një javë dhe më pas të kungohesh», dhe në vazhdim të kungohet vazhdimisht në çdo Liturgji hyjnore, në mënyrë që shpirti të marri veten dhe djalli të largohet. Nëse dikush që bën jetë të kujdesshme le ti ofrohet misterit sa herë që e ndien Kungatën hyjnore si nevojë dhe jo si zakon, por edhe kjo të bëhet me bekimin e atit shpirtëror.

### **Funksioni i dënimeve**

- Jerond, zbatimi i përpiktë i porosive na ndihmon që të ndiejmë në shpirt Perëndinë?

- Cilat porosi? e Ligjit Mosaik?
- Jo, të Ungjillit.
- Zbatimi i porosive patjetër që ndihmon, por zbatimi i saktë, sepse ka mundësi që ti zbatosh edhe gabim porositë. Në jetën shpirtërore duhet drejtësia hyjnore dhe jo thjeshtë zbatimi i ligjit. Shikojmë që edhe Etërit e Shenjtë me sa shumë kujdes thoshin të zbatohen kanonet e shenjta! Vasili i Madh, Ati më i rreptë i Kishës, që ka shkruar kanonet më të rrepta, përmend kanonin që vlen për një mëkat por në vazhdim ai vetë shton: «Mos analizo kohën por mënyrën e pendesës»<sup>11</sup> . Domethënë, nëse dy njerëz bëjnë të njëjtin mëkat, ati shpirtëror, në mënyrë analoge me pendimin e secilit, mund që njërit ti ndalojë të kungohet për dy vjetë dhe tjetrit për dy muaj. Bëhet fjalë për ndryshim të madh!
- Jerond, “dënimi”, ndihmon që të priten pasionet?
- Më parë duhet që të kuptojë se një “dënim” do ta ndihmojë. Përndryshe ç’të thuash? Nëse përpiqesh që të ndreqësh një njeri me anë të drurit, nuk arrin asgjë. Ditën e Gjykimit ty që u përpoqe me anë të dhunës ta ndreqësh, Krishti do të thotë: «Diokliciani kujtoje se ishe?» dhe atij do ti thotë: «Gjithçka që bëre, e bëre me anë të dhunës». Nuk do ta mbytim tjetrin, që ta dërgojmë në Parajsë, por do ta ndihmojmë të kërkojë vetë ndonjë ushtrim. Të arrijë në pikën që të gëzohet që jeton, të gëzohet që vdes.

“Dënimet” janë në gjykimin e atit shpirtëror. Tek ata të cilët mëkatojnë me gjakftohtësi ati shpirtëror duhet të jetë i rreptë pa bërë mbrapa. Atij që mundet, por që pendohet, përulet, kërkon me përgjërime falje, do ta ndihmojë me kujdes që ti afrohet përsëri Perëndisë. Kështu bënin edhe shumë Shenjtorë. Shën Arseni i

---

<sup>11</sup> Shih Shen Vasili i Madh, Letra 217, paragraph. 84, PG 32, 808B.

Kapadhokisë p.sh. si at shpirtëror nuk u vendoste kurrë dënime njerëzve. Përpiqej që ti sillte në gjendjen që të kuptonin, në mënyrë që me dëshirën e tyre të kërkonin ushtrime shpirtërore apo të jepnin lëmoshë apo të bënin mirësi të tjera. Kur shikonte ndonjë fëmijë të demonizuar apo sakatë dhe kuptonte që shkaktarë ishin prindërit që fëmija vuante, më parë shëronte fëmijën dhe më pas vendoste tek prindërit rregulla të rrepta që në vazhdim të kishin kujdes.

Disa thonë: «Filan at mbështetet shumë tek etërit. Është shumë i rreptë! Është i zgjuar, ka kujtesë, e di Pidhalion<sup>12</sup> përmendësh». Një at shpirtëror që zbaton përpikmërisht rregullat që përmend Pidhalion mund ti bëjë keq Kishës. Nuk është e dobishme që një at shpirtëror të marr Pidhalion dhe të fillojë: «Ti çfarë mëkati ke bërë? Këtë çfarë shkruan këtu për këtë mëkat? Të mos kungohesh për kaq vjetë! Ti çfarë bërë? Këtë. çfarë shkruan këtu? Këtë kanon!».

- Jerond, duhet që të kesh parasysh qindra gjëra.
- Po, sidomos në epokën tonë nuk ia vlen të zbatosh gjithë ligjin e Kishës me një rreptësi dhe pa takt por, duhet të kultivojë tek njerëzit sedrën. Pikë së pari të punoj me veten e tij, që të mund të ndihmoj shpirtrat, përndryshe do të shkatërrojë jetët e njerëzve.

Pidhalio quhet kështu sepse i drejton njerëzit një herë në këtë drejtim dhe herë tjetër në tjetër drejtim, por i zoti i varkës që të shkojë në breg e kthen varkën një herë majtas dhe një herë djathtas. Nëse e mban vetëm drejt, pa u kthyer aty ku duhet, do ta hedhë varkën në shkëmbinj, do ta zhys dhe njerëzit do të mbyten. Nëse ati shpirtëror i përdor rregullat strikt ashtu siç janë, dhe jo

---

<sup>12</sup> Antologji e Regullave (Kanuneve) të Kishës Orthodhokse, e cila përmbledh Kanonet e Shenjta e Sinodeve Ikumenike gjithashtu edhe Kanonet e Etërve të Shenjtë të Kishës duke përfshirë dhe një shpjegim të vogël. U formulua rreth vitit 1793 nga Shen Nikodhimi nga Mali i Shenjtë dhe nga murgu Agapios.

me dallim sipas njeriut dhe pendimin që ai bën, në vend që të shërojë shpirtra, do të gabojë.

### **Lutja falëse**

Disa etër shpirtërorë kanë një rregull: Kur të rrëfyerit nuk i lejohet që të kungohet, nuk i lexojnë lutje falëse. Disa të tjerë thonë: «E kemi zakon të mos lexojmë gjithmonë lutje falëse». Kjo dëgjohet si diçka protestante... Erdhi një herë një djalosh i ri në Kalivi që kishte bërë shumë mëkate. Shkoi, u rrëfye, por ati shpirtëror nuk ia lexoi uratën e faljes. I shkreti, ishte dëshpëruar. «Përderisa ati shpirtëror nuk më lexon lutje faljeje, kjo do të thotë që as Perëndia nuk më fal», mendonte dhe donte të vriste veten. «I thashë, të shkosh tek ati shpirtëror të të lexojë lutje faljeje. Dhe nëse ai nuk ta lexon, shko tek një at shpirtëror tjetër».

Pa lutje falëse do të kishte rënie të vazhdueshme, sepse djalli nuk i humbet të drejtat. Si të luftojë njeriu, përderisa djalli ka akoma të drejta mbi të? Nuk është i çliruar, pret vazhdimisht ndikime demoniake. Ndërsa me lutjen e faljes ndikimet demoniake pushojnë, bëhet ripushtin i territorit, kështu që shpirti ndihmohet dhe mund të luftojë e të përpiqet që të çlirohet prej pasioneve.

## *Testamenti shpirtëror i Jerondit*

Unë murgu Pais,  
Pasi analizova veten time,  
Kuptova se kam shkelur  
Të gjitha porositë e Zotit,  
Kam bërë të gjitha mëkatet.  
Nuk ka rëndësi nëse disa i kam bërë  
në masë më të vogël,  
sepse nuk ka aspak lehtësime për mua  
ngaqë Zoti më ka bamirësuar shumë.

Lutuni që Krishti të më mëshirojë.

Më falni dhe të falur qofshin  
të gjithë ata që mendojnë se më kanë hidhëruar.

Falënderit shumë,

Përsëri ju them, lutuni për mua.

*Murgu Pais*

### *Mesazhi i Jerond Paisit<sup>13</sup>*

«Më parë besojmë tek Perëndia dhe më pas duam Perëndinë dhe ikonën e tij, njeriun. Besimi shtohet me anë të lutjes. “Shtona besimin”».

«Siç kam kuptuar, e gjithë e keqja e ka prejardhjen nga mosbesimi. Kur njeriu nuk i beson Perëndisë, dëshiron të shijojë jetën e tij prandaj dhe jepet në çdo lloj mëkati».

«Njeriu duhet të perceptojë kuptimin më të thellë të jetës, se qëllimi i kësaj jete është që të përgatitemi për jetën tjetër. Që aty e në vazhdim, ashtu sikurse dikush që udhëton i nevojitet një drejtues, kështu edhe për udhëtimin qiellor duhet të gjej një drejtues (at shpirtëror). Pastaj ta vendos në një program, pak studim, pak lutje, t’iu shmanget shkaktarëve të mëkatit, dhe frymës së botës që është më e keqe nga të gjitha. Kështu që në këtë mënyrë zemra e tij do jetë tek Krishti».

«Duhet të përpiqemi me sedër të shpëtojmë që të mos mërzisim Krishtin. Krishti do të na thotë: “Biri im unë bëra kaq shumë për të të shpëtuar. Derdha gjakun tim dhe durova kaq pësime, ti çfarë bëre për shpëtimin tënd?”»

«Çdo njeri duhet të gjejë dhe të shenjtërojë dhuntinë e tij. Njeriu punëtor, kudo që të ndodhet, qoftë në martesë, qoftë në murgjëri, do jetë i suksesshëm».

«Të preferojmë dëshpërimet dhe ti pranojmë më tepër se sa gëzimet. Ilaçi i hidhur shumë herë është më i mirë se i ëmbli, sepse shëron dhe jep rezultate. Gëzimi i vërtetë lind nga dhimbja».

---

<sup>13</sup> Në vend të epilogut, përmblohdhëm disa pjesë karakteristike të mësimëve të Jerondit.

«Ajo që e pengon njeriun që të përparojë në jetën shpirtërore është se nuk e vë në punë trurin e tij për ato që janë të dobishme për jetën shpirtërore por e vret për të tjera gjëra». «Duhet që brenda nesh të hyj dhimbja për gjendjen e sotme që të mundemi të bëjmë lutje me zemër».

«Sot ka ardhur koha që të ndahen delet nga dhitë, besimtarët nga të pabesët. Më vonë do të vijë koha që të japim provime, do të pësojmë vuajtje dhe përndjekje për besimin tonë, dhe atëherë do të dallohet bakrri nga ari».

«Kur dikush mërzitet sepse vuan për të tjerët, ndjen dhembshuri për të tjerët, bën problemet e tyre të tijat, atëherë ai ka rrogë martiri. Njerëzit që sakrifikojnë gjithçka janë shumë të hirshëm! Nuk kanë as problem dhe fytyra e tyre shkëlqen sepse kanë vazhdimisht gëzimin hyjnor».

«E gjithë baza e jetës shpirtërore është të mendosh për të tjerët ndërsa veten tënde ta vendosësh në fund, të mos e llogarisësh. Kur vijmë në pozitën e të tjerëve dhe e kuptojmë, atëherë jemi të afërm me Krishtin».

«Hiri i Perëndisë është gjë e shtrenjtë. Që të vijë e të banojë brenda njeriut, duhet që ta gjejë njeriun të jetë i njëjtë me Frymën e Perëndisë dhe njeriu të ushtrojë gjithë anën njerëzore. Ndërsa ne dëshirojmë që të vijë hiri hyjnor dhe të na çlirojë nga dobësitë, pa përpjekje. Që të banojë brenda njeriut Shpirti i Shenjtë nevojitet shumë vetmohim, shumë sedër, përlësi dhe sakrificë. Jeta shpirtërore nuk është shijim. Krishti ka vënë prizën por kabujt tanë janë të ndryshkur dhe nuk e pranojnë hirin hyjnor. Le të pastrojmë ndryshkun nga kabujt, të luftojmë të njohim veten tonë, ti presin pasionet tona, të fitojmë virtytet dhe kështu të na vizitojë hiri i Perëndisë». Atij i përket lavdia dhe pushteti në jetë të jetëve. Amin.



RRËFIMI – PENDIMI

Jerond Porfiri

## BIOGRAFI E SHKURTËR

Jerondi oshënar Porfir, me emrin e botës Evangjelos Bairaktaris, lindi në 7 Shkurt të 1906, në Evia, në fshatin Agios Ioannis të rrethit Karistia. Prindërit e tij, Leonidas Bairaktaris dhe Eleni, mbiemri i lindjes Antoniu Lambru, ishin njerëz shpresëtarë dhe besimtar të devotshëm. Madje babai i tij, ishte psalt në fshat dhe kishte njohur personalisht Shën Nektarin. Familja e tij përbëhej nga shumë vetë dhe prindërit, që ishin bujq të varfër, vështirësoheshin që të kujdeseshin për të. Prandaj dhe babai i tij u detyrua të shkonte në Amerikë ku punoi dhe në hapjen e kanalit të Panamasë.

Evangelji i vogël ishte fëmija i katërt i familjes. Ruante delet në mal dhe kishte ndjekur vetëm klasën e parë të fillores kur u detyrua dhe ai për arsye të varfërisë së madhe të shkonte në Halkidha që të punonte. Ishte vetëm shtatë vjeç. Punoi për dy-tre vjetë në një dyqan. Më pas shkoi në Pire, ku punoi në një dyqan bakalli i një të afërmi.

Në moshën dymbëdhjetë vjeçare fshehurazi iku për në Malin e Shenjtë, me dëshirën e zjarrtë që të ndihmonte Shën Joan Kalivitin, jetën e të cilit e kishte lexuar që prej vitesh më parë dhe e kishte dashuruar shumë. Hiri i Perëndisë e udhëzoi të shkojë tek qelia e Shën Gjergjit në Kafsokalivia dhe të jetë nën bindjen e dy Jerondëve, vëllezër truporë, Pandeleimonit, i cili ishte dhe at shpirtëror, dhe Joanikit. U përkushtua tek të dy Jerondët, të cilët sipas pohimeve të shumta ishin shumë të rreptë, me dashuri të madhe dhe me frymë bindjeje absolute.

U bë murg në moshën katëmbëdhjetë vjeçare dhe morri emrin Nikita. Pas dy vjetësh u bë murg me skimë të madhe. Pak më vonë Perëndia i dhuroi hirin tejshikues.

Në moshën nëntëmbëdhjetë vjeçare Jerondi u sëmur rëndë, gjë që e detyroi që të braktisë përgjithmonë Malin e Shenjtë. Atëherë u kthye në Evia, dhe u vendos në Manastirin e Shën Harallambit në Lefko. Një vit më pas, në 1926, në moshën njëzet vjeçare, u hirotonis prift në kishën e Shën Harallambit të Kimit nga Porfiri i tretë, Kryepishkop i Sinait, i cili i dha emrin Porfir. Kur ishte njëzet e dy vjeç u bë at shpirtëror – rrëfyes dhe pak më pas arkimandrit. Për një periudhë kohore punoi si prift enorie në Cakeus, një fshat në Evia.

Në Evia, në Manastirin e Hirshëm të Shën Harallambit, jetoi dymbëdhjetë vjetë, duke u shërbyer njerëzve si at shpirtëror dhe rrëfyes, dhe tre vjetë në Ano Vathia, në Manastirin e braktisur të Shën Nikollës.

Në vitin 1940, vigjilje e Luftës 2-të Botërore, Jerond Porfiri u vendos në Athinë, ku edhe morri përsipër detyra famulltari dhe at shpirtëror në Poliklinikën e Athinës. Siç edhe ai vetë thoshte, jetoi atje tridhjetë vjetë si të ishte një ditë, duke ushtruar pa u lodhur veprën shpirtërore dhe duke lehtësuar dhimbjen dhe sëmundjen e njerëzve.

Që nga viti 1955 ishte vendosur në Kalisia, ku kishte paguar nga Manastiri i Pendelit manastirin e vogël të atjeshëm të Shën Nikollës së bashku me zonën bujqësore që ishte përreth, të cilën e punonte me kujdes të madh. Këtu, paralelisht, ushtronte dhe veprën e pasur shpirtërore.

Në verën e vitit 1979, shkoi të qëndrojë në Milesi me ëndrrën që të ndërtonte një manastir. Në fillim jetonte atje në një karavan

në kushte shumë të vështira dhe më vonë në një qeli të vogël prej blloqesh betoni ku edhe duronte pa u ankuar të gjitha sprovat e shëndetit të tij. Në vitin 1984 u transferua në një ndërtesë të manastirit që po ndërtohej, për themelimin e të cilit Jerondi megjithëse ishte shumë sëmurë dhe i verbër, punonte pa pushim dhe pa u lodhur. Me themelimin e Kishës (Kishë) të Manastirit të Shpërftyryrimit, në 26 Shkurt të vitit 1990, u denjësuata shikojë ëndrrën e tij të realizuar.

Vitet e fundit të jetës së tij tokësore filloi të përgatitej për fjetjen e tij. Dëshironte që të kthehej në Malin e Shenjtë, në Kafsokalivia që aq shumë kishte dashuruar, ku ashtu siç jetoimistikisht dhe pa zhurmë, do të dorëzonte shpirtin tek Dhëndrri i tij. Shumë herë e dëgjuan të thoshte: «Kam ndërmend dhe tani që u plaka të shkoj dhe të vdes atje lart».

Dhe me të vërtetë, fundi oshënar e gjeti në Kafsokalivia, në qelinë e tij, në mëngjesin e 2 Dhjetorit të vitit 1991.

Fjalët e fundit që u dëgjuan nga goja e tij ishin nga lutja arkieratike e Zotit, ato që aq shumë i kishte përzemër dhe i përsëriste dhumë shpesh: «Që ata të jenë një».

Fjala e Etërve dhe Nënave të shenjta, e cila buron nga përjetimi origjinal kishtar, të qetëson dhe të udhëzon, shkatërron iluzione, siguron zemrën, mbështet ndërgjegjen, gjallëron besimin, hap rrugë drejt jetës së përjetshme dhe drejt Mbretërisë së bekuar të Atit, të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë, ashtu siç na e tregon Liturgia dhe adhurimi Ortodoks.

Fjala e Jerond Porfirit është fjalë e Atit të shenjtë, fjalë e parashikuesit, e modestit, e të përvullurit, e të thjeshtit dhe të zjarrtit, jeta e të cilit ishte origjinale dhe një dëshmi e vërtetë e Krishtit, e të

vërtetës dhe e gëzimit të Tij. E njeriut i cili me prezencën, dashurinë, lutjen, fjalën dhe këshillat e tij, mbështeti me qindra njerëz në orë të vështira sëmundjeje, zije, dhimbjeje, braktisjeje dhe vdekjeje.

Jerondi i paharruar është Ati hyjmbajtës i ditëve tona, kleriku origjinal dhe mësuesi i cili dashuroi në mënyrë asketike Krishtin dhe i shërbeu me të vërtetë njeriut. Mësimet e tij janë të vaditura me moralin dhe teologjinë e Kishës Ortodokse dhe në to mbizotëron personaliteti dhe ikona e Krishtit dhe Shpëtimtarit të të gjithëve.

## RRËFIMI – PENDIMI

**Është oferta e dashurisë së Perëndisë**

**për njeriun**

At Porfiri tha:

«Zemra jonë duhet të jetë e mbushur me dashuri, me dashurinë e Perëndisë. Kjo dashuri na jep fuqi dhe hir. Të gjitha dituritë vijnë pas dashurisë».

«Rrëfimi është një mënyrë që njeriu ti ofrohet Perëndisë. Është ofertë e dashurisë së Perëndisë për njeriun. Askush dhe asnjë nuk mund ta privojë njeriun nga kjo dashuri».

**Nuk mundonte asnjë njeri**

Ndihesha shumë rehat pranë Jerond Porfirit. Nuk nxiste asnjërin. Donte që kushdo që shkonte pranë tij të shkonte me lirinë dhe dëshirën e tij. U thoshte gjithmonë atyre që rrëfeheshin tek ai, kur si etër shpirtëror udhëzojmë ata që rrëfihen tek ne, duhet që gjithmonë të respektojmë lirinë e tyre, duke theksuar se Krishterimi është liri.

Na tregonte gjithmonë ngjarjen, sipas së cilës Krishti tha diçka dikur, dhe nga e cila gjë shumë u skandalizuan dhe në vazhdim filluan të largohen derisa ikën të gjithë dhe mbeten vetëm nxënësit e tij. Kështu që Krishti u tha edhe atyre se nëse dëshironin të iknin, ishin të lirë. Ashtu siç thotë dhe Ungjilli sipas Joanit: «Që nga ai çast, shumë nga dishepujt e tij shumë nga dishepujt e tij u

tërhoqën dhe nuk ecnin më me të. Atëherë Jisui u tha të dymbëdhjetëve: “A doni edhe ju të largoheni?”».

### **Të pranonte me dashuri**

Të pranonte me dashuri dhe tregonte dashuri, kushdo që të ishte, sido që të ishte. Pranë tij, akoma edhe mëkati më i madh merrte dimensione të tjera. Nuk tronditeshe, nuk të pushtonte dëshpërimi. Vetëm mërziteshe që kishe bërë këtë apo atë mëkat, përse nuk zbatove dëshirën e Perëndisë. Jo vetëm nuk të lejonte që të dëshpëroheshe nga mëkatet e tua, por përkundrazi të ndihmonte që pas çdo rënie të fitoje diçka, në mënyrë që ta përdorje si një ringritje për një fillim të ri, për një fitore të re shpirtërore. Dhe atëherë tregonte dashuri më të madhe, një pëlqim më të madh. Të merrte për dore dhe fillonte të të mësojë se si të ecësh në rrugën e Perëndisë.

### **Si rrëfente Jerondi**

Në momentin kur hynte dikush për tu rrëfyer, e... shikoj. Kur ikën e shoqëroj me lutje, i dërgoj dashurinë time derisa del jashtë dhe derisa të vinte tjetri. Është më mirë të dërgosh dashurinë ashtu në heshtje se sa ta thuash me fjalë.

### **Kur rrëfesheshe nuk të shikonte në sy**

Kur në moshën njëzet e një vjeçare At Porfiri u bë prift dhe në vazhdim në moshën njëzet e tre vjeçare at shpirtëror, të gjithë ata që shkonin për tu rrëfyer, nuk i shikonte në sy që të mos viheshin në pozitë të vështirë dhe ndiheshin keq. Iu hidhte një shikim kur hynin dhe në vazhdim ulte kokën. Shumë herë,

përpara se të fillonin ti flisnin, iu thoshte: «Nga letra që ke shkruar vetëm numri tre dhe pesë janë mëkate, të tjerat nuk janë mëkate. Më thuaj për treshin dhe pesën dhe nëse do të na ngelet kohë, më thua dhe për të tjerat».

### **Me dashuri të palodhshme**

E jetova nga shumë afër Jerondin dhe mësova peshën e punëve që kishte. Shumë herë rrëfente që nga mëngjesi deri në darkë, pa asnjë pushim dhe pa futur asgjë në gojë!

### **Të rrëfeheni shpesh, të kungoheni dhe ti doni njerëzit**

E takuam për pak çaste, madje për shumë pak. Sepse gjatë mëngjesit Jerondi kishte takuar, kishte folur dhe kishte rrëfyer shumë njerëz. Prandaj duke parë se sa i lodhur ishte, u mjaftuam me përshëndetjen dhe morrëm bekimin e tij. Së bashku me bekimin e tij, na tha edhe dy gjëra të cilat ishin të mjaftueshme të kuptonim se çfarë njeriu ishte dhe se çfarë do të bëheshim ne. Na tha: «Bijtë e mi, të rrëfeheni shpesh, të kungoheni dhe të keni dashuri për njerëzit». Asgjë tjetër. Nuk mendoni se kjo i thotë të gjitha?

### **Rrëfimi dhe armiqësia**

Kur akoma Jerond Porfiri ishte i ri dhe i shëndetshëm, rrëfente shumë besimtarë dhe si at i dhimbshur, çfarëdo që ti thoshin, i falte të gjitha. Vetëm iu bënte në fund pyetjen: I mban të keqe ndonjërit? Dhe nëse i thoshin se nuk i mbante të keqe asnjërit, tregonte shumë dashuri, por nëse i thoshnin se i mbante të keqe vëllait apo nuses apo një personi tjetër, atëherë fillonte ti



shpjegonte misterin e faljes dhe të mëshirës për njerëzit, sepse mëkati i të afërmëve tanë, sado i madh që të jetë përpara mëkateve tona, në sytë e Perëndisë nuk është asgjë. Pikërisht këtë zemërgjerësi tonën do të shfrytëzojë Perëndia që të na falë mëkatet, të cilat janë të panumërueshme.

Madje do të ishte budallallëk që njeriu të humbas në ferrin e përjetshëm, ngaqë nuk që të largojë ligësinë dhe armiqësinë për njerëz të njëjtë si ai.

### **Një klimë rehatie dhe besnikërie, në rrënjë të problemit**

Siç na thatë, kishit për vite me radhë Jerond Porfirin si at shpirtëror dhe udhëzues. – Pikërisht ai ishte vendi ku shkëlqeu me të vërtetë. Si fillim me thjeshtësinë që e karakterizonte, i krijonte çdo njeriu që shkonte pranë tij një klimë rehatie dhe besimi, që janë të domosdoshme për kryerjen e misterit të Pendimit dhe të Rrëfimit.

Këtu duhet të themi se shumë njerëz që përpara klerikëve të tjerë vështirësoheshin të pohonin gjëra të ndryshme, para Jerondit të lumur, ndiheshin të lirshëm dhe rrëfeheshin.

Jerond Porfiri dëgjonte gjithçka që i thoshin njerëzit, sepse kishte hirin e dëgjimit baritor. I dëgjonte njerëzit me kujdes dhe më pas fliste – ndërsa flajët e tij ishin gjithmonë epigramatike, edhe siç thamë gjithmonë i bazuar në parimin e individualitetit. Çdo njeri që shkonte, ishte për Jerondin një personalitet unik dhe i papërsëritshëm dhe me vlera të pafundme.

Problemet që i parashtronin, Jerond Porfiri i përballonte me kujdes të veçantë, me ndjenjë përgjegjësie dhe me shumë lutje.

Karakteristike ishte ta shikojë të heshtur gjatë misterit të rrëfimit dhe ndiejë që lutej dhe kërkonte ndriçimin e Perëndisë.

Karakteristike ishte gjithashtu që nuk nxitohej që të jepte përgjigje, me qëllim që të fitonte admirata. Disa herë na thoshte: «Nuk kam informacion tani, nuk mund tju them». Dhe e sillnim këtë temë për herë të dytë apo të tretë.

Lutej ditë e natë për problemet e njerëzve dhe për zgjidhjen e tyre. Gjithë njerëzit, që u denjësuuan të komunikojnë me të dhe të bëheshin bij të tij shpirtërorë, kanë shumë për të treguar për frytet e kësaj lutjeje, me anë të së cilës i jepte zgjidhje problemeve të tyre. Ajo që ishte me të vërtetë tronditëse gjatë rrëfimit tonë tek Jerondi i lumur, ishte se ajo që shumë herë ajo që na nënvizonte si rrënjë të problemit që kishim, dukej krejtësisht pa lidhje me problemin tonë. Dhe ajo që na e emërtonte si rrënjë të problemeve tona, ishte egoizmi, të cilin e konsideronte si sfondin e gjithë problemeve të tjera të njeriut.

### **Arsyet e problemeve**

Jerondi tregonte:

Kur shërbeja në Poliklinikë, shumë shpesh të ndodhte që kur doktori fillonte që të vizitonte të sëmurin ndërsa ai reagoonte duke thënë se nuk kishte dhimbje në atë vend por diku tjetër. Atëherë doktori i thoshte: «Mund të kesh dhimbje atje por problemi është në tjetër vend». Dhe Jerond Porfiri vazhdonte: «Kështu ndodh dhe në jetën shpirtërore. Nërsa ne mendojmë se gjërat janë në këtë formë, ndërkohë që në vërtetë arsyet për ato që ndodhin brenda nesh dhe në jetën tonë». [Jer. 60]

## **Rrëfim i përgjithshëm**

Thoshte:

«Biri im, pas kohrash të gjata le të bëhet një rrëfim i përgjithshëm, sepse trauma të ndryshme psikologjike apo probleme serioze na shkaktojnë sëmundje trupore. Kur rrëfehemi nuk duhet të themi vetëm mëkatet tona por edhe mendimet e ndryshme, p.sh. frikën, trishtimin, gëzimin, mërzitjen që kalojmë nga ngjarje të ndryshme – apo ngjarje siç janë tërmetet, vdekjet, martesat, pabesitë etj.».

Kur Jerondi mbaroi punë në Korinthia dhe morrën rrugën e kthimit. Në kanalën e Korintit qëndroi për të ngrënë. Oficeri i forcave ajrore, që e shoqëronte, porositi një racion të plotë ndërsa Jerondi vetëm një domate. Pas darkës vazhduan rrugën dhe gjatë rrugës në një moment i kërkoi që të qëndronin. Dolën jashtë, u ulën në një shkëmb, ndërsa poshtë shtrihej deti. Atëherë Jerondi i tha: «Tani është koha të më rrëfesh jetën tënde në përgjithësi. Por më mirë mos mi thuaj ti, do ti them unë. Dhe atëherë dëgjoi nga goja e Jerondit të gjitha mëkatet, që kishte ndërmend ti thoshte e të gjitha ato që kish harruar por mbi të gjitha edhe ato që nuk i kishte shkuar fare në mendje se mund të ishin mëkate të tij. Jerondi i bëri pastrim të përgjithshëm të shpirtit. Ai rrëfim i mbeti i paharruar».

### **Duhet të shkojmë tek ati shpirtëror**

Jerondi më thoshte: «Sa më shumë largohet njeriu nga Perëndia, aq më shumë mërzitet dhe mundohet nga gjëra të ndryshme». Dhe më thoshte akoma se: «Duhet të shkojmë tek ati shpirtëror kur kemi diçka që na mundon».

«Duhet të rrëfesh rregullisht dhe saktë, sepse edhe Patriark të jesh nëse nuk rrëfesh nuk shpëtohesh», më tha një herë tjetër.

### **Hiri largohet prej mosbindjes dhe rikthehet me anë të rrëfimit**

Thoshte se, me anë të misterit të Rrëfimit të Shenjtë, çdo gjë që është e rrëzuar përdhe ngrihet lart. Na kishte treguar rastin e një murgu i cili kishte shkuar që në moshë të vogël në Malin e Shenjtë dhe që kishte shumë hire që e bënë të ndjehesh se jetonte në parajsë. Një herë nuk iu bind Jerondit të tij dhe me këtë gjë i iku dhe i gjithë hiri që kishte. Kur u kthye dhe u rrëfye dhe iu lexua lutja e faljes, menjëherë iu rikthye hiri që kishte humbur.

Jerond Porfiri gjithmonë theksonte se, kur ndodhemi brenda Kishës, kur marrim pjesë në Misteret e Kishës, ndodhemi në parajsë. Dhe sa më shumë marrim pjesë në Misteret, aq më tepër jemi në jetën e përjetshme. Prandaj dhe na kujtonte gjithmonë fragmentin e Ungjillit që thotë: «Kush beson në Birin ka jetë të përjetshme, kurse kush nuk i bindet Birit nuk do të shohë jetë, por zemërimi i Perëndisë qëndron mbi të».

### **Depoja e gjërave të vjetra**

Një grua u kujtua dhe më tha: dikur Jerondi më tha: «Shumë prej juve grave, çdo gjë të vjetër dhe të shkatërruar që keni, enë kuzhine të vjetra, mobilje, këpucë dhe sende të tjera të prishura, shkoni dhe i hidhni në ndonjë magazinë të fshehtë dhe e mbyllni dhe kështu qetësoheni. Por nuk e dini se do vijë një ditë që këtë vend të fshehtë do ta zbulojë dikush dhe do t'ju ekspozojë».

Ngela i habitur nga fjalët e Jerondit. Ato ditë lexoja libra të psikologjisë pimantike, që flisnin se si të largojmë përjetime traumatike nga ndërgjeshmëria në nëndërgjegjem e shpirtit tonë dhe për zhytjen në një kohë të pacaktuar. Shembulli më i gjallë i Jerondit, për magazinën e mbeturinave, më mësonte shumë më tepër se sa manualet shkencore. Simbolizmi i përmendur për mëkatet tona ishte shumë i qartë, të cilat mëkate nuk i zhdukëm me pendim dhe rrëfim por i hodhëm me nxitim në magazinën e harresës në mënyrë që ti shmangeshim prezencës së tyre të bezdisshme, dhe të cilat mëkate do ti «gjej» Zoti, që ti risjellë përsëri në kujtesën tonë «në ditën e gjykimit». Ai i di ndërsa ne nuk iu japim rëndësi.

### **Përderisa mëkatin që bëre e rrëfeve,**

#### **mos e thuaj përsëri**

- Jerond, rrëfeva tek ati im shpirtëror një mëkat por dua që t'jua them edhe juve.
- Përderisa ia the atit shpirtëror nuk është nevoja të ma thuash edhe mua. Përderisa e rrëfeve dhe u pendove, more edhe faljen.

#### **Mos u dëshpëro**

- Jerond a e dini se sa mëkat të madh që kam bërë?
- Ti je i fortë prandaj mos ki frikë se do ta kalosh.
- Por, Jerond është shumë mëkat i madh.
- Mos u dëshpëro. Ke shpirt të mirë dhe Perëndia që e shikon këtë, do të të falë dhe do të ndihmojë.

## Që tani e në vazhdim të kujdesesh

### të ndryshosh mënyrë jetese

Një herë Jerond Porfiri u nis së bashku me tre bij shpirtërorë të shkojnë për të kryer një Mbrëmësore, në një Manastir. Fillimisht mendoheshin të shkonin më këmbë. Por pasi përshkuan një distancë dhe meqenëse Jerond Porfiri ishte i lodhur dhe ngaqë Manastiri ishte pak larg, menduan që të gjejnë një mjet transportues se sa të shkonin më këmbë.

Në atë moment u duk nga larg një taksi. Atëherë shoqëruesit e Jerondit, të cilët ishin laikë dhe jo klerikë, thanë që ti bënin me shenjë që të qëndronte dhe ta pyesnin nëse mund ti çonte tek Manastiri. «Mos kini frikë», iu tha- «do të qëndrojë vetë shoferi i taksisë por kur të hipim në taksi të mos i flas asnjëri prej jush shoferit, do ti flas vetëm unë». Dhe kështu u bë. Shoferi i taksisë qëndroi pa i bërë shenjë, hipën në taksi dhe Jerond Porfiri i tha se ku do të shkonin. Sapo u nisën, shoferi i taksisë filloi të flas kundër priftërinjve dhe ti akuzojë për një mijë e një gjëra. Sa herë që thoshte diçka u drejtohej tre laikëve, të cilët ishin ulur në sediljet e pasme të taksisë, dhe i pyeste: «Kështu nuk është djema? Ju si mendoni?». Por ata qëndronin të heshtur sipas porosisë së Jerondit dhe nuk thoshnin asgjë.

Pasi u lodh duke pritur përgjigje prej tyre dhe nuk morri asnjë, atëherë u kthye nga Jerond Porfiri dhe i tha: «Kështu nuk është at? Si mendoni dhe ju? Këto gjëra që thonë dhe gazetatat, nuk janë të vërteta? ». Atëherë at Porfiri i thotë: «Biri im, do të them një histori të vogël, do ta them vem një herë nuk është nevoja për herë të dytë». Dhe filloi ti tregojë: «Ishte një njeri nga filan vend (Jerondi e përmendi vendin), i cili kishte një komshi të moshuar dhe që kishte një pronë të madhe. Një natë e vrau dhe e varrosi komshiun. Në vazhdim, me dokumente të ndryshme të fallsifikuara, mori

pronën e komshiut dhe e shiti. Dhe a e di se çfarë bleu me paratë që mori nga shitja e pronës? Bleu një taksì».

Sapo dëgjoì këto shoferi i taksisë u trondit aq shumë sa që qëndroi makinën në anë të rrugës dhe bërtiti: «Mos vazhdo Jerond, vetëm unë dhe ti e dinë këtë».

«E di dhe Perëndia», iu përgjigj Jerond Porfiri. «Ai ma tha, që ta them ty. Të kujdesesh që tani e tutje të ndryshosh mënyrë jetese».

### **Pendimi është si rrufeja**

U shtrova për pak kohë në spitalin Evangjelismo për terapi. Më mundonte çështja që nuk isha i përgatitur shpirtërisht. Gjatë një vizite që më bëri Jerondi i thashë: i lutem Perëndisë që të më japë edhe pak vite jetë, që të pendohem. Dhe ai mu përgjigj: Nuk është nevoja për vite, pendimi është si rrufeja.

### **Ai që nuk pendohet do të humbasë**

- Jerond, ju lutem më thoni diçka për jetën shpirtërore.
- Kushdo që nuk pedohet do të humbasë.
- Ta them përsëri, kushdo që nuk pendohet do të humbasë.

### **Të kini kujdes se tek kush at shpirtëror shkoni**

Një vëlla më tha: Një herë shkoi bashkëshortja ime të rrëfehej, kur punoja në fshat, tek një at shpirtëror shumë i rreptë dhe kur i tha dobësinë e saj që do ta përsëriste, i bërtiti, e frikësoi dhe prej atëherë kaloi shumë kohë pa shkuar të rrëfehej. «E shikon, i tha Jerondi se çfarë bën rreptësia e tepërt? Prandaj ju them që të keni kujdes se tek cili at shpirtëror shkoni të rrëfehëni si ti,

bashkëshortja jote por dhe fëmijët e tu dhe mbi të gjitha të jeni të sinqertë me ato çka thoni, sepse Perëndia kështu i fal të gjitha dhe përparoni shpirtërisht».

### **Disa etër shpirtëror bëjnë krime**

Shiko biri im! Perëndia ynë në mënyrë që Ti mësojë fëmijët e tij, që besojnë, e duan dhe e adhurojnë, përdor mënyra, plane dhe metoda të ndryshme. Brenda planit të Perëndisë është edhe dhënia e rregullave (kanuneve), dhe të cilat gjithmonë kanë për qëllim shpëtimin e shpirtëve tanë. E njëjta gjë vlen edhe për rastin tënd. Nuk mundemi të ndryshojmë apo të fshijmë planet e Perëndisë. Dhe për më tepër nuk mundemi që ti nxisim plane. Por ne mund ti lutemi, ti përgjërohemi dhe Ai, si njeridashës që është, mund të dëgjojë lutjet tona dhe të pakësojë kohën por edhe ta fshijë. Edhe njëra edhe tjetra janë në dorën e tij. Ne do ti kërkojmë ndërsa ai do të aprovoj. Pastaj, këto rregulla nuk kanë për qëllim dënimin, por kanë qëllime pedagogjike dhe nuk kanë asnjë lidhje me ato çka disa etër shpirtëror inponojnë gjatë rrëfimit dhe të cilët, nga zelli i tepërt, apo nga padija, zhdukin kufijtë e dënimit, pa kuptuar se me këtë mënyrë, në vend që të bëjnë mirë, kryejnë një krim. Unë ju bërtas gjithmonë dhe i këshilloj: Jo dënime të mëdha por këshilla të sakta. Sepse dënimet e rënda ushqejnë djallin dhe me këtë gjë pasurohet klientela e tij dhe ai pikërisht këtë prët. Dhe madje ju premtan përralla me mbret... Prandaj duhet kujdes i madh në përzgjedhjen e atit shpirtëror. Ashtu siç këkoni doktorin më të mirë, të njëjtën gjë të bëni edhe me atin shpirtëror. Që të dy janë doktorë. Njëri është i shpirtit dhe tjetri i trupit.



## I mjeri, sa shumë u gabua!

Jerondi, me shenjtërinë e tij të vetvërtetuar, nuk përbënte vetëm një vlerë të padyshueshme shpirtërore, por bëhej, pa e synuar ai vetë masë vlerësuese për nivelin shpirtëror të të tjerëve. Një miku im kishte një herë një peripeci të papritur: Nuk binte dakord me një të njohurin e tij për një çështje serioze dhe në përpjekje për tu pajtuar me të, mendoi të kërkojë mbështetjen e një njeriu shpirtëror, që nuk e kishte takuar asnjëherë. Pa pyetur më parë për mentalitetin e tij, shkoi pa patur dyshime, e takoi dhe i hapi zemrën, madje me frymë besimi dhe duke përvulur veten e tij. Por ai e përballoi me ashpërsi dhe madje u përpoq që ti bënte psikanalizë cfilitëse. Sepse ndërsa kundërshtarin e tij e lavdëroi për virtytet e tij, atë e kritikoi për dobësitë e tij, duke e akuzuar për mendimet e tij dhe në vazhdim duke e siguruar se i fliste për të mirën e tij. Kështu që në vend që të mbyllte boshllëkun midis tyre e transformojë në distancim akoma më të madh. I shqetësuar miku, nga kjo që pësoi, iu drejtua at Porfirrit i cili që nga çasti i parë «pa» qartë problemin e tij dhe i tha: Për kundërshtarin e tij: «A e di se si të shikon ai tani? Si milingonë». Ndërsa për atin shpirtëror: «Po-po! Sa shumë që u ngatërrua i bekuari!!! Ku e ka mendjen! U mbështet në informacionet që i tha kundërshtari yt dhe ty të nxorri skarto. Me këtë gjë mund ta dëmtosh shumë tjetrin. Disa etër shpirtëror bëjnë sikur janë psikiatër».

Kjo ngjarje e dhimbshme me shokun tim më bëri që të mendoj: Nëse i bekuari, nuk dëshiron që të dëgjojë për veten e tij fjalën e Profetit Isai «Sepse emri i Perëndisë blasfemohet për ne nëpër kombet », të paktën duhej që çdo njeri ta pres me përvulësi, si krijesë të Perëndisë dhe jo ta shikojë me mendjemadhësi si «milingonë». Ati shpirtëror nëse nuk dëshiron që të jetë një bari i gënjeshtërt që dëmton bagëtitë e tij, të paktën të ketë takt, të jetë i dhimbshur dhe i paanshëm sepse nëse mban anë në favor «të

tanëve» dhe është kundër «të huajve». Perëndia do të gjejë mënyrë që të mbrojë «të huajtë». Gjithashtu duhet të mos bëhet psikiatër. Rruga e tij është shenjtëria më Krishtin, në mënyrë që me pastrimin në etapa dhe ndriçimin e shpirtit, të arrijë të ketë vetëdije të plotë dhe gjithashtu të kuptojë edhe të tjerët.

Përkundrazi, nëse ndjek metodat psikiatrike dhe madje nuk ke asnjë kompetencë, atëherë do të çorientohet dhe nuk do të ketë asnjë shpresë përmirësimi, përderisa edhe vetë psikiatrët përballojnë pengesa të pakapërcyeshme gjatë fazës së njohjes dhe të terapisë së shpirtit.

Prandaj dhe përzgjedja e një ati shpirtëror të shenjtë dhe jo të ketë frymën e botës, përbën një çështje të përgjegjshme për çdo besimtar ortodoks. Kur për kërkimin e doktorit, që do ti besojmë trupin tonë të prishshëm nuk ju japim rëndësi mundimeve, kohës, shpezimeve, distancave, sa shumë më tepër duhet të përpiqemi të kërkojmë atin shpirtëror, të cilit do ti besojmë shpirtin tonë të përjetshëm? Etër shpirtëror të mirë ekzistojnë, por ngaqë janë të përulur, si at Porfiri psh., fshihen. Që ti gjejmë duhet që të përulemi, të mundohemi shumë, ashtu si polumbarët, që kërkojnë në fund të oqeanit margaritarët e çmuar. Është një kërkim që në fund të sjell gëzimin e madh të zbulimit, ashtu siç na siguron edhe Krishti: «Mbretëria e qiejve i ngjan një thesari të fshehur në një arë, që një njeri, që e ka gjetur, e fsheh; dhe, dhe nga gëzimi i tij, shkon, dhe shet gjithçka që ka dhe e blen atë arë».

### **Kur ati shpirtëror mungon**

- Jerond, ngaqë ati im shpirtëror mungon, dua bekimin tuaj që të kungohem nesër.
- Urren ndonjë njeri?

- Jo, Jerond.
- Në rregull. Të shkosh të kungohesh.

### **Kur ndodhesh larg**

Kur për shkak të zhvendosjeve për arsye të punës, ndodhesha në distance të largëta, At Porfiri paralelisht me atë si at shpirtëror më kishte dhënë bekimin që për rrëfimin e mëkateve të mia të ndryshme të shkoja tek Jerondët e lumur at Eleftherio Kapsomeno në Hania të Kretës, «atë shenjtorë të madh dhe atë njeri që qëndronte shumë lartë përpara Perëndisë», siç më thoshte shumë herë dhe tek Jerondi i shenjtë protopresviter Joan Tamkin, meshtarin e mrekullueshmëm të Ipsistou, që shërbente në Kishë pa pushim deri në pleqëri të thellë (96 vjeç), deri në ditën e fjetjes së tij. «Shumë Jerond i nderuar ai prift. Tek ai të shkosh biri im, që të rrëfesh gjatë kësaj kohe mëkatet e tua», më tha, kur nuk rrëfente më për arsye shëndëtsore.

### **Disa etër shpirtërorë të ngatërrojnë**

Kur ndodhesh larg Athinës, i tha një vëllai dhe nuk mundesh të vish rregullisht këtu, të kërkosh që të gjesh atje një at shpirtëror shumë të mirë që të rrëfesh mëkatet e tua. Dhe gjithçka që ka lidhje me lutjen mendore apo me mendime të mos ia thuash, sepse disa nuk i dinë të gjitha këto tema dhe mund të të ngatërrojnë. Të vish këtu dhe të më thuash të tjerat.

## **Kij kujdes se çfarë u thua etërve shpirtëror**

«Kujdes se çfarë iu thua etërve që rrëfesh. Sepse nuk i dinë të gjitha. Etërit shpirtëror duhet të jenë shumë të urtë, të kenë takt dhe gjithashtu të kenë përvojë. Të kenë frymë Perëndie, që të mund të zgjidhin problemet që ke».

Këtu duhet të sqarohet, se këtu nuk e kishte fjalën për mëkatet e thjeshta që të gjithë kryejmë në të përditshmen tonë, por për nocione më të thella, si p.sh. për lutjen mendore, për fyejtjet e të ligut etj..

### **Nuk e di...**

Disa herë u desh që ta pyesja për priftërinj-etër shpirtëror, sepse njerëz të rrethit tim të ngushtë miqësor kërkuan mendimin tim, në mënyrë që të shkonin të rrëfeshin tek ata. Jerondi shumë herë më jepte përgjigje pozitive, pak herë mu përgjigj: «Nuk e di». Jerondi respektonte personalitetin e të gjithëve dhe shprehej me shumë kujdes, sidomos kur bëhej fjalë për episkopë, priftërinj dhe shumë më tepër për etër shpirtëror.

### **Ka drejtues shpirtërorë që frymëzohen nga fryma papiste**

Po bisedoja me të një çështje. Bëhesh fjalë për një at të rreptë shpirtëror, i cili nuk pranoi që biri i tij shpirtëror të bënte dëshirën e tij, që të vizitonte at Porfirin, që ti fliste për një problem serioz që kishte. Kjo ngjarje më kishte bërë të çuditesha shumë dhe ia thashë. Jerond Porfiri tundi kokën i mërziur dhe pëshpëriti: «Çfarë të thuash? Siç e shikon është dhe at shpirtëror».

Jerondi ishte gjithmonë i butë dhe i kujdesshëm në gjykimet e tij për të tjerët, sidomos kur bëhej fjalë për priftërinj që bënë gabime.

Në vend që ti karakterizonte kështu apo ashtu preferoi të më flas në mënyrë parabolike: «E di që një misionar katolik kur merr një urdhër për një mission, i hipën aeroplanit në Romë dhe kur mbërrin në territorin afrikan, hap një zarf dhe lexon se cili është misioni i tij, që është i detyruar ta zbatojë edhe në qoftë se nuk bie dakord. Me ne orthodhoksët nuk ndodh kështu». Përafërsisht e kuptova se çfarë donte të më thoshte. Megjithëse nuk ishte hera e parë që konstatoja që brenda në ambientin orthodhoks ka edhe etër shpirtëror, fatmirësisht të paktë, që frymëzohen në thelb nga fryma papike, dhe që kërkojnë zbatimin e urdhrave të tyre, duke mos marrë parasysh rezistencën e brendshme të bijve të tyre shpirtëror. Ngaqë e kanë frikë lirinë, imponojnë disiplinën dhe harrojnë, se bindja orthodhokse është fryt i ndërgjegjes së lirë.

### **Një Jerond pa takt**

Disa muaj përpara se të njihja at Porfirin, meqenëse gjendesha në një nevojë të madhe shpirtërore në të njëjtën kohë, një mik i ngushtë më njoftoi për një Jerond nga Mali i Shenjtë dhe i cili qëndroi për një kohë të shkurtër, për të cilin thoshin se kishte hir parashikues, shkova e vizitova pa marrë më parë leje nga ati im shpirtëror. Por ai Jerond në vend që të më qetësojë, ma shtoi më tepër tronditjen. Kur këtë ngjarje ia përmenda atit shpirtëror, mu përgjigj: Nëse do të më kishe thënë, nuk do të të jepja bekim të shkoje të takoje atë njeri. Kur erdhi koha, dhe me nxitjen e atit tim shpirtëror tashmë, njoha at Porfirin, i cili më paqësoi plotësisht, i tregova edhe për atë takimim me Jerondin nga Mali i Shenjtë. At Porfiri e njihnte dhe më tha me modesti: «Tani e ka marrë Perëndia. Është shumë çështje e hollë. Nuk ishte shumë i zoti i bekuari. Dikujt i kishte thënë që do bëhej dhespot dhe tani ai dëshiron që ta heq rrasen. Perëndia e faltë».

## **Ke shumë at të mirë shpirtëror**

Në një nga herët e fundit që e pashë Jerondin më tha:

- Dëgjo P., ke shumë at të mirë shpirtëror. Nuk duhet të vish më këtu. U hidhërova, u hidhërova shumë atë moment. Vallë përse e ka fjalën? Po më ndjek? Përse? Tani e di. E di që ishte testamenti i tij shpirtëror. Me të vërtetë ati im shpirtëror është ai që ngrë tani barrën e gjithë dobësive të mia. Urata e Jerondit le të bëjë veprën e tij të rëndë dhe të mundimshme më të lehtë

**Kur e detyroja At Porfirin që të aprovonte dëshirën time,  
gjithmonë dilja i humbur**

Shpesh herë e pyesja.

- At, të shkoj atje?
- Të shkosh, më thoshte, nëse e shikonte që do të kaloja mirë. Por kur shikonte që nuk do të kaloja mirë apo do të më ndodhte diçka, më thoshte jo.

Unë, ngaqë më pëlqente të shkoja atje dhe që në fillim kisha pyetur, përpiqesha me justifikime të ndryshme ti ndroja vendimin fillestar. Në vazhdim ai nuk ma prishte qejfin, por mbaj mend me siguri se nuk kaloja mirë ose diçka tjetër do të më ndodhte, nëse nuk përputhej me bekime të tij të parë.

## **Të veprosh me bekimin e Kishës dhe të atit shpirtëror**

At Porfiri i thoshte Episkopit të mëvonshëm serb Irine Buloviç: «Dëgjo, biri im. Kur të gjitha këto ti kërkon Kisha dhe i

bekon ati shpirtëror dhe ti bindesh sinqerisht, atëherë, me dashurinë e Krishtit tonë, kjo bindja jote do të kthejë të gjithë këtë lëvizje të jashtme në lutje, pa e kuptuar ti vetë. Nëse përsëri zgjedh një vend të qetë në Malin e Shenjtë apo cilindo Manastir, por këtë e bën me dëshirën tënde, qoftë edhe shpirtërisht dhe pa bekimin e Kishës dhe të atit shpirtëror, atëherë gjithçka që të bësh nuk do të përparosh dhe nuk do të të çojnë asgjekundi».

Dhe siç na thotë ai vetë, mund t'ju rrëfej se që atëherë, sa herë që vështirësohesha, kujtoja fjalët e Jerondit dhe menjëherë qetësohesha. Dhe kjo gjë vazhdon deri në ditët tona.

### **Rrëfimi tek at Porfiri.**

#### **Nuk ekziston dëshpërimi në Orthodhoksi**

Takimi i parë me at Porfirin ishte shumë i qetë dhe miqësor, pa asnjë vrazhdësi apo zyrtësi gjëra që mund ti fantazonte dikush duke menduar se bëhej fjalë për Jerond asket. Me qetësi dhe butësi dëgjonte ato që i rrëfenin shpirta të paqëndrueshëm, si të ishin biseda të zakonshme të përditshme. Si të ishin gjëra që i dinte.

Një paqe dhe një lumturi që shpërndahej përreth dhe zbuste shpirtat tanë. Që nga njohja për herë të parë të gjitha ngurrimet që kishim para se ta njihnim, u zhdukën. Asnjë rreptësi çnjerëzore. Vetëm dashuri njeridashëse dhe frymë faljeje. Dëgjonte, njëkohësisht lutej me komboskinin, bekonte dhe falte.

«Është gjë e madhe ati shpirtëror», do të na thoshte më vonë. «Prandaj në Orthodhoksi nuk ka dëshpërim. Nuk ka rrugë pa krye. Sepse është ati shpirtëror, i cili ka hirin të fal. Dhe fillonte me thjeshtësi të na tregonte histori për njerëz që u çliruan me anë të rrëfimit».

## Melankolia, përulësia dhe ati shpirtëror

Një natë ishim mbledhur një grup së bashku me një at nga Mali i Shenjtë. U errësua. Qielli ishte mbushur me re dhe ishte kërcënues. Por, pranë Jerondit, edhe për ata që nuk janë mësuar me errësirën e natës në natyrë, paqja nuk tronditej. Jerondi fliste për ndryshimin e Përulësisë nga inferioriteti. I përuluri, thoshte, nuk është një personalitet i shkatërruar. Ka ndërgjegje të gjendjes që ndodhet, por nuk e ka humbur qendrën e personalitetit të tij, vogëlsinë e tij dhe pranon qortimet e atit të tij shpirtëror dhe të vëllezërve të tij. Mërzitet, por nuk dëshpërohet. Trishtohet, por nuk asgjësohet e as nuk nxehet. Ndërsa ai që gjedet i ngecur në rrjetën e inferioritetit, nga ana e jashtme në fillim, ngjan me të përulurin. Por nëse e ngacmon pak, ose ta këshillosh, atëherë egoja e sëmurë zgjohet, tronditet, humbet edhe atë pak paqe që ka. E njëjta gjë ndodh, thoshte, me atë që është patologjikisht melankolik në lidhje me mëkatarin e penduar. «Ai që është melankolik vjen vërdallë dhe merret vetëm me veten e tij. Ndërsa mëkatarin, që pendohet dhe rrëfëhet, del prej vetes së tij. Kjo është madhështorja e besimit tonë: rrëfyesi, ati shpirtëror. Nëse ia thua Jerondit dhe mer edhe falje, mos u kthe mbrapa». Këtë e theksonte shumë. Të mos kthehesh tek e kaluara por të përparosh. Sa e sa të skllavëruar në dëshpërim kishte shpëtuar në çastin e fundit duke i tërhequr me fuqinë e konfidencës së tij tek Perëndia!



Tekstet janë të marrë prej librave:

**Ligjëratat e Jerond Paisit**, Manastiri i Hirshëm i Shen Joan Theologut, Suroti Selanik.

**Antologji e Këshillave të Jerond Porfirit**, Botim i Manastirit të Hirshëm të Grave «Shpërfytyrimi i Shpëtimtarit».

## RRËFIMI

### Misteri i pajtimit

#### Klinikë shpirtërore

Çfarë është në të vërtetë rrëfimi? Një mister i madh i kishës sonë. Misteri që na shfaq hapur dashurinë dhe njeridashjen e Perëndisë. Mëkati është sëmundje e shpirtit ndërsa ai që shkel dëshirën e Perëndisë është i sëmurë nga ana shpirtërore. Kisha me anë të misterit të rrëfimit shfaqet në botë si një qendër e madhe mjekësore, ku hiri i Perëndisë shëron sëmundjet shpirtërore dhe bën mirë plagët e shpirtit, të cilat plagë ia shkaktojnë njeriut shigjetat e mëkatit.

Themelues dhe ndërtues i këtij misteri të madh është vetë Zoti ynë. Duke na thënë: «*Pendohuni, sepse mbretëria e qiejve është afër*» (Matth. 4, 17) filloi dhe vepra e Tij botshpëtuese, dhe në vazhdim pas ngjalljes së Tij, t'ju dorëzoi nxënësve të Tij pushtetin shpirtëror të falin mëkatet e njerëzve «*Kujt do t'ia falni mëkatet, do t'i jenë falur, kujt do t'ia mbani, do t'i jenë mbajtur* » (Joan. 20, 23).

Akoma duhet të themi se qendra mjekësore shpirtërore e Kishës është e hapur për çdo njeri, sado mëkatar qoftë. Ftesa e Krishtit është e përgjithshme; «*Ejani tek unë, të gjithë ju të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t'ju çlodh*» (Matth. 11, 28). Të gjithë ata që ndiejnë në supet e tyre mundimin dhe peshën e mëkatit, ftohen që të shijojnë paqen dhe lirinë, qetësinë dhe gëzimin që fal Krishti.

## **Kushte të domosdoshme**

Cilat janë kushtet që duhet ti afrohemi misterit të rrëfimit? Më themeloret janë vetëdija, pendimi dhe vendimi për ndryshim. Vetëdija përbën një eksperiencë tronditëse në rrugën tonë drejt shpëtimit. Njeriu që fillon të ndiejë që është mëkatar, të shikojë pasionet e shpirtit të tij, pendohet thellë, përulet dhe gjen strehë tek Perëndia, tek Ati i dhembshur, që të mbështes përsëri në këmbët e tij gjithë qënien e tij.

Vetëdija e mëkatit të çon në pendim dhe në vendimin për ndryshim. Pendimi është një shtytje e fuqishme e njeriut për ndryshim rrënjësor. Të ndryshoj mendje, ndjenja, mënyrë jetese. Që aty e në vazhdim të jetojë jetën e Krishtit dhe të trupëzojë me luftën e tij shpirtërore virtytet ungjillore.

## **Me kujdes dhe sinqeritet**

Natyrisht këtu lind pyetja tjetër: Si duhet të rrëfehemi? Pikë së pari, para se të nisemi për tu rrëfyer, duhet të lutemi nxehëtësisht. T'i lutemi Zotit të na japë pendim të thellë dhe të sinqertë. Në këtë klimë lutjeje dhe përqendrimi le të mendojmë mëkatet tona. Mund të jetë e nevojshme ti shkruajmë në një letër, që të mos presim që ti kujtojmë në momentin e fundit apo të na pyes ati shpirtëror.

Gjatë rrëfimit duhet të ndiejmë që nuk ndodhemi përpara një njeriu të thjeshtë, por përpara vetë Perëndisë; sepse Perëndia gjendet pa u dukur dhe dëgjon rrëfimin tonë. Kjo do të na ndihmojë shumë që të mos kemi turp dhe të jemi absolutisht të sinqertë, gjë që është shumë e domosdoshme për rrëfimin. Nëse nuk jemi të sinqertë jo vetëm nuk na falen mëkatet, por u shtojmë atyre edhe mëkatin e tmerrshëm të mosrespektimit të Zotit. Perëndia e di brendësinë e shpirtit tonë me hollësinë më të vogël.

Gjithashtu është gabim që gjatë rrëfimit të shfaqim edhe mëkatet e të tjerëve dhe të spostojmë peshën e përgjegjesisë sonë. Rrëfejme vetëm mëkatet tona. Jo të të tjerëve. Dhe marrim përsipër personalisht peshën e përgjegjesisë të veprave tona. Siraku i urtë na këshillon: «*Mos ki turp të pohosh mëkatet e tua*» (4, 26).

## **Hezitime të pambështetura**

Shumë prej vëllezërve tanë të krishterë, ndërsa pranojnë rëndësinë e madhe të misterit të rrëfimit në jetën kristiane, megjithatë ngurrojnë për disa anë të saj. Kështu vështirësohen të marrin vendimin e madh të trokasin derën drejt rrëfimit.

Rezervimet më të theksuara lidhen me personin e atit shpirtëror. Shumë pyesin veten: «*Si mundet një njeri i thjeshtë ashtu si ne, të falë mëkate?*». Mundet, sepse shumë thjeshtë, ka marrë hirin priftëror dhe pushtetin shpirtëror të «*lidhin...dhe të zgjidhin*» (Matth. 18, 18). Mësimet e Shkrimit Shenjtë janë të qarta. Ati shpirtëror nuk e kryen këtë vepër me fuqitë e tij personale por me fuqinë e Perëndisë. Kështu që mëkatet nuk i eliminon askush tjetër përveç hirit të Krishtit. Ati shpirtëror thjeshtë është organ i hirit.

Disa të tjerë pretendojnë: «*Përse të shkoj tek priftërinjtë, përderisa edhe ata bëjnë të njëjtat mëkate por edhe më të këqija?*» Ky kundërshtim, në rastin që nuk është shpifje prej armiqve të besimit më të shumtën e herëve dhe produkt i që kanë për qëllim akuzimin e padrejtë dhe gjë që bëhet prej të gjithë nesh. Pikërisht kjo pikë përbën një pretekst dhe jo një justifikim të logjikshëm. Etërit na propozojnë: «*Ashtu si i sëmuri kërkon që të zbulojë të gjejë doktorin specialist dhe të dalluar për sëmundjen e tij, kështu edhe ti kërko dhe gjej atin e mirë shpirtëror dhe me përvojë, madje*

nëse beson se vlerë më të madhe nga shëndeti i trupit ka shpëtimi i shpirtit tonë». Le të mobilizojmë, pra, pretekste të lehta.

Një kategori tjetër njerëzish pretendojnë: «Nuk rrëfhem sepse priftërinjtë ua thonë të gjithëve ato që rrëfen. Nuk iu kam besim». Edhe këtu duhet të kuptojmë se bëhet fjalë për një keqkuptim të tmerrshëm, që në mënyrë artistike kultivon i ligu në shpirtrat e njerëzve që ti largojë nga hiri i saktë i Misterit. Duhet që ta kapërcejmë një frikë të tillë. Ati shpirtëror duke pasur parasysh, se sa mëkat i madh dhe sa shkelje e rëndë është shpërndarja e mëkateve të rrëfyera, nuk shkel në asnjë mënyrë sekretin e misterit. Prandaj le të mos na mashtrojë djalli.

### **Rrëfimi tek ikona është i gabuar!**

Ekziston edhe një kategori tjetër të krishterësh që pretendon se: «Preferoj t'ia them ikonës». Ky është një argument shumë naiv. Ikona nuk ka pushtet të tillë, dmth. të dëgjoj dhe të falë mëkatet e njerëzve, fjala e Perëndisë është shumë e qartë.

Për më tepër, në një rast të tillë, si është e mundur të mësojmë nëse Perëndia na fali? Në vazhdim, në problemet e ndryshme shpirtërore kush do të na udhëzojë? Kush do të na këshillojë? Kush do të na japë ilaçet e duhura shpirtërore që të shërohem nga pasionet tona të ndryshme? Kështu që nuk mund të rrëfhem tek ikonat.

### **Marshim i vazhdueshëm**

Disa të tjerë pretendojnë se: «Përse të rrëfhem, përderisa të njëjtat mëkate do ti bëj përsëri?». Dhe ky është një argument shumë sipërfaqësor. Gjë që as edhe jeta e përditshme nuk e

vërteton përderisa edhe tek doktori shkojmë përsëri, kur sëmuremi tjetër herë dhe rrobat i lajmë sa herë që fëlliqen dhe kaq shumë raste të tjera. Përse, pra, mos të bëhet e njëjta gjë edhe për shpirtin tonë? Jeta shpirtërore është një marshim i vazhdueshëm për fitimin e shenjtërisë dhe të virtytit. Të lumtur janë ata që e ndjekin atë. Dhe nëse pengohen dhe bien, pak rëndësi ka, mjafton të ngrihen dhe të vazhdojnë përsëri. Zoti e mban gjithmonë hapur derën e pendimit dhe na pret.

### **Kurthi i shtytjes së rrëfimit**

Ajo që është më e zakonshme nga të gjitha ato që njerëzit shfaqin që t'i shmangen rrëfimit është spostimi. «*Kemi kohë. Më vonë*», dëgjojmë shumë. Pa mëdyshje duhet të themi se shtytja spostimi është justifikimi më i rrezikshëm, është kurth i vërtetë sepse vë në gjumë ndërgjegjen e njeriut dhe zhduk çdo problematizim të shenjtë nga zemra e tij. Harrojmë se nuk jemi pushtetar të kohës dhe se nuk kemi bërë kontratë se kur do ta ikim prej kësaj bote. Si mund të parashikojmë me kaq lehtësi se sa do të jetojmë apo kur do të vdesim? Nuk shikojmë kaq vdekje të papritura, kaq aksidente, kaq sëmundje?

Pastaj, nëse e mira më e madhe është pajtimi dhe bashkimi me Perëndinë – dhe kjo gjë presupozon domosdoshmërisht rrëfimin-, përse të na mungojë një e mirë e tillë? Pra, le të dëgjojmë porosinë e Perëndisë: «*Mos u vono të kthehesh tek Perëndia dhe mos e shty pendimin tënd nga dita në ditë. Sepse zemërimi i Zotit do të vij papritmas*» (Urt. Sirak. 5, 7).

## Ftesa hyjnore

Zoti na drejton një ftesë madhështore: «*Bir, ma jep mua zemrën*» (Fj. Urt. 23, 26). Perëndia kërkon zemrën tonë. Ta pastrojë në banjën e pendimit, tek ky mister i madh i Kishës sonë dhe ta shenjtërojë me hirin e Tij.

Nuk ka rëndësi se çfarë kemi bërë deri më sot. Gjëja më e madhe dhe më e rëndësishme është se çfarë do të bëjmë që tani e tutje. Çfarë do ti përgjigjemi ftesës së Tij.

Hiri i Perëndisë qoftë me ne dhe na frymëzofte në vendimin heroik të pendimit dhe të drejtofte hapat tona drejt rrëfimit, tek kjo qendër mjekësore e shpirtit. Atje do të ndiejmë lirinë e vërtetë dhe gëzimin e vërtetë. Atje do të gjejmë qetësi dhe paqe. Atje do të jetojmë misterin e dashurisë së Perëndisë, i cili për shpëtimin tonë u bë njeri, u kryqëzua dhe u ngjall.

*“Uroj që Perëndia me ndërmjetimet e jerondëve oshënarë Pais dhe Porfir ti jap botës pendim.”*

## RRËFIMI I PASTËR

### Mësime nga Shen Kozmai i Etolisë

Vëllezërit e mi, nëse dëshironi që të kuroni shpirtat tuaj, katër gjëra ju nevojiten.

**E PARA:** Nëse dëshironi që të rrëfeheni, themeli i parë është, **TË FALNI ARMIQTË TUAJ**, dhe t'ju jepni të drejtën të gjithë atyre që padrejtësuat.

**E DYTA:** Të gjeni At Shpirtëror të përshtatshëm, të shkolluar, të virtytshëm që të rrëfeheni dhe të thoni të gjitha mëkatet tuaja. Nëse ke bërë 100 mëkate dhe rrëfeve tek Ati Shpirtëror vetëm 99 prej tyre dhe **NJË NUK IA THEMI, TË GJITHA MËKATET NUK FALEN**. Kur mëkaton duhet të të vijë turp, dhe kur rrëfesh të mos kesh aspak turp.

**E TRETA:** Kur të rrëfesh do të tëp yes Ati Shpirtëror: «Përse biri im i bërë këto mëkate?» Të kesh kujdes mos të fajësosh dikë tjetër por vetëm veten tënde dhe të thuash: «**I BËRA NGA VULLNETI IM I KEQ**».

**E KATËRTA:** Kur Ati Shpirtëror të të jap falje dhe të largohesh, të vendosësh me bindje që më mirë të derdhësh gjak se sa të mëkatosh.

**MOS THUAJ KURRË:**

*«Kjo është diçka e parëndësishme, le të mos e rrëfej».*

Sepse ashtu siç thotë Apostull Jakovi: «**SEPSE KUSHDO QË E ZBATON GJITHË LIGJIN, POR E SHKEL NË NJË PIKË, ËSHTË FAJTOR NË TË GJITHA PIKAT**».(Jakov. 2, 10)



## UDHËZUES

### MËKATET I REFEROHEN PERËNDISË, TË AFËRMIT DHE VETES TONË

Para se të paraqitësh në misterin e shenjtë të rrëfimit veçohu në një vend të qetë dhe lutu Perëndisë që të të jap Pendim të vërtetë. Kushto pak kohë në mënyrë që të përgatitesh siç duhet. Ktheji sytë tek vetja jote, ndiqe ecurinë e gjendjes së brendshme shpirtërore dhe kontrollo me kujdes veten tënde në lidhje me këto:

JU PËRGJIGJEMI POZITIVISHT TË GJITHA MËKATEVE DHE  
DUKE I THËNË SHUMË HERË (SH. H.).

#### I) POROSIA E DASHURISË PËR PERËNDINË

1. Nuk e dua Perëndinë me gjithë zemër.
2. Nuk e dua Perëndinë më tepër se të gjithë njerëzit e mi të dashur, më shumë se gjërat e mia dhe më tepër se VETJA IME.
3. Nuk jam i gatshëm që të parashtoj veten time në çdo lloj sacrifice për hir të dëshirës së Perëndisë.
4. Nuk e dua të afërmin tim. (Sh. H.)
5. Nuk lutem për të (afërmin) dhe për ata që më bënë keq dhe më dëmtuan.
6. Nuk punoj misionarisht me vetmohim që të njohin edhe njerëz të tjerë Krishtin dhe të shpëtohen.
7. Me dashje apo pa dashje jam shkaktar që të humbasin shpirta. (Sh. H.)
8. Nuk jap shpesh me përlësi dhe sipas mundësisë lëmoshë.

9. Nuk dëshiroj lumturinë dhe përparimin SHPIRTËROR, MATERIAL, FAMILJAR DHE PROFESIONAL e të tjerëve. (Sh. H.)
10. Nuk dua që të më mungojë asgjë për hatër të të afërmit. (Sh. H.)
11. Nuk kam shpëtuar dhe nuk kam ndihmuar njerëz që kishin nevojë. (Sh. H.)
12. Nuk paqësova as nuk pajtova njerëz por bëra të kundërtën. (Sh. H.)
13. Nuk ngushëllova dhe as nuk ndihmova ata që kishin nevojë. (Sh. H.)
14. Tregoj indiferencë dhe ftohtësi. (Sh. H.)
15. Nuk bëj vepra të mira, dhe ato që bëj i bëj përgjysëm, dhe kërkoj SHPËRBLIM. Jam fajtor për çdo TË KEQE që kam kryer dhe për çdo TË MIRË që nuk kam kryer.
16. Indinjohem dhe trishtohem për të mirën që kam bërë. (Sh. H.)
17. Nuk zotëroj frymë sacrifice dhe frymë luftarake dhe takt nuk kam.
18. Nuk jam TOLERANT dhe nuk i FAL të afërmit e mi. (Sh. H.)
19. Kur kam faj nuk përulem dhe nuk kërkoj falje. (Sh. H.)
20. Jam zemërgurtë – LIGËSI. (Sh. H.)
21. Antipati – URREJTJE. (Sh. H.)
22. Smira, Armiqësia, Shpirtligësia. (Sh. H.)
23. Kur nga smira shkaktojmë prishjen e paqes dhe dashurisë së një familjeje, ose vëllazërisë murgjërëre dhe përgjithësisht njerëzve të dashur.
24. Më vjen keq për të mirat e atij që kam zili.
25. BLASFEMI ME DASHJE APO PA DASHJE TË SHPIRTIT TË SHENJTË. (Sh. H.)
26. TË MBAJTURIT MËRI, XHELOZIA. (Sh. H.)
27. Hidhëroj të tjerët pa arsye. (Sh. H.)

28. Jam fajtor për çështje Kishtare. (Sh. H.)
29. PËRGOJIMI. (Sh. H.)
30. Dëgjoj përgojime dhe gënjeshtër dhe nuk reagoj. (Sh. H.)
31. FLAS KOT. (Sh. H.)
32. ANKOHEM, JAM BESËPAKË. (Sh. H.)
33. MALLKOJ, THEM FJALË TË NDYRA. (Sh. H.)
34. Bie dakord dhe hesht kur dëgjoj njerëz të tjerë të bëjnë këto gjëra. (Sh. H.)
35. Shakatë e mia janë të PAHIJSHME dhe MËKATARE. (Sh. H.)
36. Tallem me invalidë, njerëz me të meta mendore dhe të pashkolluar që të argëtohem unë ose shoqëria ime. (Sh. H.)
37. Kam SHPIFUR. (Sh. H.)
38. SHPIFJA, DISKREDITIMI, IRONIA. (Sh. H.)
39. HIPOKRIZIA DHE SERVILIZMI. (Sh. H.)
40. Lavdëroj pa dallim veten time dhe të tjerët. (Sh. H.)
41. Jam neglizhent. (Sh. H.)
42. Mospërpjekje shpirtërore. (Sh. H.)
43. Këshillime drejt mëkatit. (Sh. H.)
44. Plogështia kundrejt çdo të mire. (Sh. H.)
45. Pavendosmëria. (Sh. H.)
46. Jam frikacak, shpirtvogël. (Sh. H.)
47. Tregoj indiferencë, pakujdesi, cektësi dhe neglizhencë ndaj detyrave të mia. (Sh. H.)
48. Nuk tregoj shpresëtarinë dhe sjelljen e duhur brenda dhe jashtë kishës. (Sh. H.)
49. Nxehem me gjënë më të vogël kundrejt Perëndisë, njerëzve, kafshëve dhe gjërave të tjera. (Sh. H.)
50. Inatosem dhe zemërohem gjë që më bën të sillem keq nga ana e jashtme dhe e brendshme dhe në këtë formë tjetërsohet psikologjia ime.
51. Besim i tepruar në veten tonë dhe jo tek Perëndia. (Sh. H.)

## II) UNË JAM ZOTI DHE PERËNDIA YT

52. Nuk kam besim të plotë dhe të patundur tek Perëndia. (Sh. H.)
53. Në Përkujdesjen (Providenca Hyjnore) e Tij. (Sh. H.)
54. Në shenjtërinë e Krishtit dhe tek Mësimet e Tij.
55. Në gjithçka që mëson Kisha e Shenjtë dhe Apostolike me anë të Shpirtit të Shenjtë.
56. Mosbesimi, besa e paktë. (Sh. H.)
57. Nuk ju jap prioritet dhe nuk përkujdesem siç duhet për veprat e Krishtit. (Sh. H.)
58. Kam turp dhe frikë të pohoj Krishtin. (Sh. H.)
59. Nuk bëj shenjë e Kryqit kur kaloj pranë kisha, kur ha dhe përpara të tjerëve. (Sh. H.)
60. Nuk pohoj Krishtin dhe Mësimet e Tij dhe nuk i nënshtrohem dëshirës së Tij përpara njerëzve në prani të njerëzve të tjerë dhe sidomos kur besojnë në diçka tjetër. (Sh. H.)
61. Mohimi i hapur apo i fshehtë i Perëndisë.
62. Mora pjesë në organizata antiortodokse – ateiste. (Sh. H.)
63. Kam mbështetur se besimi ortodoks është i njëjtë me besimet e tjera pa asnjë ndryshim. (Sh. H.)
64. Ju kam dhënë të drejtë heretikëve gjoja për argumentat e tyre të llogjikshme.
65. U luta së bashku me heretikë. (Sh. H.)
66. Shkova në medium, fallxhore. (Sh. H.)
67. Kam bërë magji që të lidhen çifte. (Sh. H.)
68. I zgjidha (çështjet, problemet) tek magjistarja dhe jo në Kishë. (Sh. H.)
69. Besoj tek ëndrrat. (Sh. H.)
70. Mora pjesë në mbledhje pnevmatistësh. (Sh. H.)

71. Hipnotizmi, eksorkizmi me kandil, çlirim nga syri i keq jo me anë të kishës, kapërcimi i zjarrit, therje gjeli në themele, rruaza, sy, qepë ose hudhra, psherëtima, patkonj. (Sh. H.)
72. Të lidh dhe të ngatërroj të afërmit e mi. (Sh. H.)
73. Besoj në paragjykitime dhe bestytini. (Sh. H.)
74. Kërkimi i mrekullive pa asnjë arsye. (Sh. H.)
75. Kërkoj nga Perëndia gjëra mëkatore. (Sh. H.)
76. Nuk kungohem me misteret e papërlyera nga indiferenca dhe neglizhenca. (Sh. H.)
77. Kungohem pa u rrëfyer dhe pa mbajtur kreshmë, dhe pa frikë Perëndie, besim, shpresë dhe dashuri. (Sh. H.)
78. Kur kungohem nuk e nderoj siç duhet Krishtin. (Sh. H.)
79. Pështytje pas Kungimit Hyjnor. (Sh. H.)
80. Nuk kam frikë Perëndie. (Sh. H.)
81. Nuk jam familjarizuar me misteret e Perëndisë. (Sh. H.)
82. Shkel kreshmët pa pasur sëmundje trupore. (Sh. H.)
83. Pa arsye serioze. (Sh. H.)
84. Pa lejen e Atit shpirtëror. (Sh. H.)
85. Nuk kam vetëdije të mëkatshmërisë sime. (Sh. H.)
86. Nuk pendohem sinqerisht. (Sh. H.)
87. Nuk kam përqëndrim shpirtëror dhe nuk e vras ndërgjegjen. (Sh. H.)
88. Kur rrëfehen akuzoj të tjerët. (Sh. H.)
89. Fsheh mëkate. (Sh. H.)
90. Nuk studioj çdo ditë Shkrimin e Shenjtë apo libra të tjerë fetarë. (Sh. H.)
91. Nuk e ndez kandilin ose e ndez me vaj të papastër. (Sh. H.)
92. Nuk luftoj kudo dhe gjithmonë me gjithë fuqinë time kundër mëkatit. (Sh. H.)
93. Nuk lutem rregullisht me besim, përulësi, shpresëtari, dëshirë dhe kujdes. (Sh. H.)

94. Nuk falënderoj gjithmonë dhe nga zemra Perëndinë për bamirësitë e panumërta dhe të përditshme që më bën. (Sh. H.)
95. Nuk e lavdëroj për madhështinë dhe Lavdinë e tij të pafund. (Sh. H.)
96. Trishtohem me sprovat dhe më pushton padurimi. (Sh. H.)
97. Ankohem ndaj Perëndisë. (Sh. H.)
98. Humbas shpresën për shpëtimin dhe ndreqjen time. (Sh. H.)

### **III) NUK DO TË KRIJOSH IDHULL PËR VETEN TËNDE.**

99. Jam egoist dhe krenar. (Sh. H.)
100. Më pëlqejnë gjërat njerëzore, mëndjemadhësi. (Sh. H.)
101. Mburrem dhe demonstroj veten time. (Sh. H.)
102. Më pëlqen vetja dhe më pëlqen të kem pushtet. (Sh. H.)
103. Kokfortësia, pangopësia, paredashja. (Sh. H.)
104. Shikoj interesin tim. (Sh. H.)
105. Skllav i modës mondane. (Sh. H.)

### **IV) KUJTO DITËN E SHTUNË**

106. Nuk shkoj në kishë ditët e diela apo në festa të mëdha pa arsye shëndeti apo ndonjë arsye tjetër serioze. (Sh. H.)
107. Në vend të Adhurimit Hyjnor dhe veprave të dashurisë merrem me vepra mëkatore. (Sh. H.)
108. Ndjek Liturgjinë Hyjnore nga radioja duke bërë ndonjë punë. (Sh. H.)
109. Largohem nga Kisha pa mbaruar Liturgjia Hyjnore ose shkoj me vonesë në Kishë. (Sh. H.)
110. Pi kafe dhe cigare para se të shkoj në kishë. (Sh. H.)

111. Nuk lutem me ato që psalen dhe lexohen, mendoj gjëra të tjera vështroj ata që ndodhen dhe hyjnë në kishë. (Sh. H.)
112. Pas kishës, bisedoj, qesh, qëndroj pa shprestari edhe në qoftë se kryhet dasëm apo ndonjë shërbesë tjetër. (Sh. H.)
113. Punoj ditët e diela apo në festa të mëdha ndërkohë që mund të mos punoja. (Sh. H.)

## V) NDERO ATIN

114. Nuk nderoj dhe nuk respektoj ashtu siç duhet prindërit e mi. (Sh. H.)
115. I trishtoj me sjelljen dhe mosbindjen time, dhe nuk e vras mendjen që të përmbush detyrimet e mia ndaj tyre. (Sh. H.)
116. Nuk tregoj respektin dhe bindjen e duhur ndaj priftërinjve, mësuesve, më të rriturve etj. (Sh. H.)
117. Jam mosmirënjohës ndaj atyre që më kanë ndihmuar dhe bamirësuar. (Sh. H.)
118. Nuk rrit fëmijët dhe bijtë e mij shpirtërorë me frymën e krishterë. (Sh. H.)
119. I shaj, i mallkoj. (Sh. H.)
120. Nuk i ruaj nga shoqëritë e këqija. (Sh. H.)
121. I pengoj të bëhen priftërinj, murgj, murgesha.
122. Ndhimova që dikush të mos bëhet prift, murg apo murgeshë apo të braktiste manastirin e pendimit të tij.
123. Si kumbar nuk interesohem për kultivimin dhe përparimin shpirtëror të bijve shpirtërorë.

## VI) MOS VRIT

124. Vrava, plagosa, godita, u grinda me të tjerë. (Sh. H.)
125. Mendova dhe tentova të vras veten. (Sh. H.)
126. Vendos në rrezik shëndetin tim dhe jetën time dhe të të tjerëve dhe shëndetin e të tjerëve. (Sh. H.)
127. Kam abortuar. (Sh. H.)
128. Të evitosh me çdo lloj mënyre të bësh fëmijë. (Sh. H.)
129. Me fjalë apo me vepra ndihmova që të tjerët të bëjnë mëkatet e mësipërme. (Sh. H.)
130. Nga pakujdesia përhapa sëmundje ngjitëse. (Sh. H.)
131. Zemërohem. (Sh. H.)
132. Lëkundem, shaj. (Sh. H.)
133. Përbuz të tjerët, çmoj të tjerët. (Sh. H.)
134. Jam sadist, i egër, i rrëmbyer. (Sh. H.)
135. Hakmarrës, Gërnjar, nevrik (Të lumur janë të butët). (Sh. H.)
136. Prekem lehtë dhe nevrikosem kur të tjerët vërtetojnë mëkatet e mia. (Sh. H.)
137. Shfrehem me arrogancë dhe them fjalë të hidhura dhe fyerëse që mërzisin të tjerët. (Sh. H.)
138. Kërkova prej Perëndisë hakmarrje për të afërm (Perëndia do ta shlyejë).

## VII) MOS KURVËRO

139. Jam fajtor i çdo lloj mëkati të turpshëm trupor. (Sh. H.)
140. Ndota çdo pjesë të trupit tim. (Sh. H.)
141. Ndota dhe mëkatova veten time me gjeste të pista veten time dhe të tjerët. (Sh. H.)
142. Kam bërë gjitha të tjerat përveç aktit seksual. (Sh. H.)



143. Telefonata erotike. (Sh. H.)
144. Mëkatova me të gjitha shqisat. (Sh. H.)
145. Shkela kurorën. (Sh. H.)
146. Jam fajtor sepse shkela kurorën e bashkëshort-it/-es.
147. Kurvërova shumë herë me mendje dhe të gjitha mëkatet trupore. (Sh. H.)
148. Dëshirova – dëshiroj gra të tjera – burra të tjerë. (Sh. H.)
149. Prostitucioni. (Sh. H.)
150. Marrëdhënie paramartesore. (Sh. H.)
151. U bëra ndërmjetës lidhjesh të paligjshme, erotike. (Sh. H.)
152. Homoseksualiteti.
153. Marrja e virgjërisë. (Sh. H.)
154. Përdhunimi. (Sh. H.)
155. Tentativë përdhunimi. (Sh. H.)
156. Marrëdhënie me njerëzit e afërm, marrëdhënie me kafshët, nekrofilia, pedarasti. (Sh. H.)
157. Masturbimi i vetes ose i të tjerëve. (Sh. H.)
158. Mendime të fëlliqura dhe pasione për të gjitha këto. (Sh. H.)
159. Mendime dhe dëshira të fëlliqura dhe dëshira, mendime dhe dëshira të liga.
160. Kurvërimi me shikim. (Sh. H.)
161. Anomali trupore dhe shturje jo normale. (Sh. H.)
162. Mosrespektimi i vetpërmbytjes trupore gjatë të Dielave, festave, të Mërkurrave dhe të Premteve, Kreshmëve të Mëdha apo gjatë ditëve të tjera që kreshmohet. (Sh. H.)
163. Gjatë ciklit menstrual (për gruan) ndez kandilin, shkon në kishë, apo kryen marrëdhënie seksuale me bashkëshortin.
164. Më mundojnë mëkate për përdorim substancash narkotike. (Sh. H.)

165. Shitje – përdorim substancash të ndaluara të çdo lloj.  
(Sh. H.)
166. Dehje, pangopësi, grykësi. (Sh. H.)
167. MË PËLQEN VETJA. (Sh. H.)
168. Kur nëna nuk e ushqen foshnjën nga gjiri i saj që të mos prish trupin e saj. (Sh. H.)
169. Bixhozi (edhe në qoftë se luan pa para), zaret, Duhani, plangprishje (shpenzim pa hesap), dorështrënguar, luksi.  
(Sh. H.)
170. Kam marrë pjesë në lojra fati. (Sh. H.)
171. Pamje të ndyra në kinema, teatër, televizor. (Sh. H.)
172. Tekste dhe figura me përmbajtje imorale. (Sh. H.)
173. Këngë me përmbajtje mëkatore. (Sh. H.)
174. Marr pjesë në biseda me përmbajtje imorale. (Sh. H.)
175. Argëtime mëkatore, të pahijshme dhe të shëmtuara.  
(Sh. H.)
176. Lejoj mendjen time të ndotet nga mendime dhe dëshira të papastra dhe të pahijshme. (Sh. H.)
177. Jam fajtor mëkatesh e pshndjellëse dhe kënaqësi prurëse dhe i dëshirave të tjera mëkatore dhe të liga. (Sh. H.)
178. Kryeva me duartë e mia gjeste të pahijshme. (Sh. H.)
179. Them fjalë të ndyra (Shokuese). (Sh. H.)
180. Vepra dhe shprehje të shëmtuara. (Sh. H.)
181. Munxosa, mallkova, për veten time për të tjerët dhe them fjalë që nënkuptojnë ndyrësi. (Sh. H.)
182. Veshja ime është e shëmtuar dhe provokuese. (Sh. H.)
183. Shkova në karnavale apo festa të tjera dhe u vasha (burrë/grua). (Sh. H.)
184. Koketeri. (Sh. H.)
185. Të vendosësh grurë të zier në mënyrë që të mësojë se cilin apo cilën do të martohet apo kur nusja shkruan emrin e vajzave të pamartuara në këpucën e saj. (Sh. H.)

186. Skandalizova me veshjen time. (Sh. H.)
187. Skandalizova me sjelljen dhe pamaturinë dhe u bëra fajtor smire, zilie, gjykimi dhe përgojimi. (Sh. H.)
188. Skandalizova me pakujdesinë time, veprat e mia, fjalët e mia dhe paqëndrueshmërinë time, fëmijët e mi truporë, fëmijët e mi shpirtërorë, dhe fëmijë të tjerë të vegjël në moshë apo në shpirt. (Sh. H.)
189. Skandalizova dhe mërzita Atin shpirtëror dhe nuk iu binda. (Sh. H.)
190. U skandalizova nga figura e Krishtit (gratë) dhe u skandalizova nga figura e të Tërëshenjtës (burrat).
191. Morra pjesë në konkurse bukurie. (Sh. H.)
192. Skandalizova me sjelljen time dhe me disa vepra të mia u bëra ARSYE që të tjerët të mëkatojnë. (Sh. H.)
193. Shoqëritë e mia nuk janë pozitive dhe kam zakonin e keq të qesh si i pamend. (Sh. H.)

## VIII) MOS VIDH... MOS DËSHIRO ATO QË KA I AFËRMI YT.

194. Kam Vjedhur në kishë, kam Fallsifikuar (kopjim firme, ndryshim tekstesh), kam Mashtruar. (Sh. H.)
195. Padrejtësi (padrejtësova punëtorë apo eprorë). (Sh. H.)
196. Falsifikimi, Spekulimi, Ryshfeti. (Sh. H.)
197. Blej llotari, hedh shorte, hippodrome, skedina etj.
198. Vodha, Shpërdorova para dhe sende të shtetit ose të huaja. (Sh. H.)
199. Bleva gjëra të vjedhura me dijeninë time. (Sh. H.)
200. Mbaj pa të drejtë gjëra ose borxhe. (Sh. H.)
201. Nuk u kujdesa për gjëra të huaja që më kishin dhënë dhe i shkatërrova.

202. Kur shestojmë dredhi dhe dhunojmë pasurinë e të tjerëve.
203. Fsheha ushqime dhe mallra që të përfitoja më shumë. (Sh. H.)
204. Fsheh të ardhurat e punës time që ti shmangem taksave të ligjshme. (Sh. H.)
205. Jap hua me përbindje të paligjshme. (Sh. H.)
206. Marr prqindje prej njërezve që kanë nevojë për ndihmë. (Sh. H.)
207. Kam bërë vepra të tjera të paligjshme. (Sh. H.)
208. Mbuloj dhe pranoj paligjësitë (në punë apo diku tjetër) dhe nuk bëj me dashuri dhe takt kontrollin e caktuar. (Sh. H.)
209. Si nëpunës shtetëror ose privat nuk punoj me ndershmëri, ndërgjegjshmëri, kujdes, gëzim. (Sh. H.)
210. Kur kërkujmë lëmoshë nga dembelizmi. (Sh. H.)
211. Jam kureshtar. (Sh. H.)
212. Nuk dëgjoj dhe përbuz këshillat e eprorëve nga krenaria. (Sh. H.)
213. Hapa dhe lexova letra të të tjerëve dhe përgjova. (Sh. H.)
214. Dëshirova gjëra shpirtërore - familjare, personale – dhe materiale që i përkasin të afërmve. (Sh. H.)
215. Dëshirova gruan/ burrin e të afërmit. (Sh. H.)
216. MOS KUJTO MËKATET E RINISË DHE SHKELJET E MIA. (Psalmi 24, 7)

**IX) NUK DO TA PËRDORËSH EMRIN E ZOTIT  
PERËNDISË TËND MË KOT... MOS THUAJ DËSHMI  
TË RREME**

217. Përmenda emrin e Perëndisë pa shpresëtari. (Sh. H.)
218. Përmend fjalë nga Shkrimi i Shenjtë për të bërë shaka.  
(Sh. H.)
219. Blasfemoj të Shenjtat. (Sh. H.)
220. Mendime blasfemike për Misteret Hyjnore, dogmat,  
Hyjlindësen, Shenjtorët.
221. Mosbesim ndaj dogmave e Ortodoksisë, ndaj atyre që  
thotë Shkrimi i Shenjtë, ndaj mrekullive dhe Jetëve të  
Shenjtorëve.
222. Dërgoj të tjerët në djall. (Sh. H.)
223. Betohem tek të shenjtat apo tek çdo gjë tjetër, Vura të  
tjerë të betohen. (Sh. H.)
224. Them «Për Zotin» (betim). (Sh. H.)
225. Nuk mbajta sekret. (Sh. H.)
226. Nuk plotësova një premtim – premtime (ndaj të  
shenjtave). (Sh. H.)
227. Jam jokohorent ndaj detyrave të mia dhe nuk i mbaj  
premtimet që jap. (Sh. H.)
228. Them gënjeshta gjatë bisedave dhe në punë. (Sh. H.)
229. Lëvdatë e gënjeshtërt dhe hipokrite për arsye përfitimi.  
(Sh. H.)
230. Mëkatoj jo nga pakujdesia ose nga pamundësia por  
nga dinakëria se do të rrëfhem. (Sh. H.)
231. Kam dhënë dëshmi të rreme, kam shkelur betimin,  
kam tradhëtuar. (Sh. H.)
232. Kam adhuruar persona. (Sh. H.)
233. Morra pjesë në herezi, përçarje(skizëmë). (Sh. H.)

234. Pranoj herezitë, Pranoj globalizmin (ikumenizmin), isha pjestarë në masoni ose e pranoj. (Sh. H.)
235. Rrezikoj shëndetin tim kur jam i sëmurë dhe nuk shkoj tek doktori nga kopracllëku apo indiferenca apo ngaqë keqkuptoj besimin tek Perëndia.
236. Pranoj astrologjinë – shenjat e horoskopit. (Sh. H.)
237. Pranoj teorinë e Darvinit.
238. Morra pjesë në Ruletë ose e pranoj. (Sh. H.)
239. Mendova të vrisja veten, Tentova të vras veten. (Sh. H.)
240. Nudzmi. (Sh. H.)
241. Ndërsa mundesha nuk ndalova një të keqe.
242. Qëndrova përpara ikonash kur lutesha apo përpara kishës me veshje të pahijshme. (Sh. H.)
243. Ngas makinën rrezikshëm, shkaktova aksident ose blasfemi. (Sh. H.)
244. Pranoj vdekjen klinike.
245. Torturova kafshë. (Sh. H.)
246. Përbuz të afërmit e mi. (Sh. H.)
247. Hakmerrem. (Sh. H.)
248. Profet i rremë. (Sh. H.)
249. Keqërdor mirësinë. (Sh. H.)
250. Merrja pjesë në organizata anarkiste. (Sh. H.)
251. Me dashje apo pa dashje kam vënë zjarr. (Sh. H.)
252. Fanatizëm partiak. (Sh. H.)
253. Pranoj apo bëj ryshfete në kurriz të të tjerëve.
254. Prishje familjeje, familjesh. (Sh. H.)
255. Pështyta pas Kungimit Hyjnor. (Sh. H.)
256. Idhujtari. (Sh. H.)
257. Jam besëpakë. (Sh. H.)
258. Nuk bëra kanonin (ushtrime shpirtërore, bëhet fjalë për rata që kanë një kanon të tillë), apo nuk e bëra me dashuri dhe përulësi. (Sh. H.)

259. Neglizhova të lutem për ata që kanë nevojë apo më kërkuan që të lutem për ta. (Sh. H.)

## X) PËR FAMILJEN

260. Jam i butë me veten time kur gaboj ndërsa me të tjerët i rreptë.

261. Kam kërkesa absurde nga bashkëshorti apo bashkëshortja ime. (Sh. H.)

262. Ngul këmbë, nuk kam frymë faljeje dhe mirëkuptimi. (Sh. H.)

263. Nuk përkujdesem për familjen time. (Sh. H.)

264. Ofendova bashkëshortin apo bashkëshorten time përpara të tjerëve apo në veçanti. (Sh. H.)

265. Nuk dua dhe nuk respektoj prindërit dhe të afërmit e bashkëshortes apo bashkëshortit tim. (Sh. H.)

266. Nuk kujdesem për fëmijët e mi se çfarë lexojnë, çfarë shokësh kanë dhe çfarë shikojnë. (Sh. H.)

267. Kur fëmijët nuk nderojnë prindërit e tyre, apo nuk i ndihmojnë kur ata kanë nevojë.

268. I padrejtësova kur ndava pasurinë apo në diçka tjetër. (Sh. H.)

269. Ndërhyra në familjen e fëmijëve të mi dhe u bëra arsye të krijohen mosmarrëveshje midis çiftit, të grinden apo të ndahen. (Sh. H.)

270. Nuk i administroj siç duhet të ardhurat e familjes time apo të parave të tjera që më janë besuar. (Sh. H.)

271. Kam humbur kryqë, ikona dhe sende të tjera me bekim dhe u bëra shkaktar ta shkelin me ose pa dashje. (Sh. H.)

272. Pastromë nga ato që nuk i noh (nga mëkatet e mia që nuk i njoh, të cilat nuk ranë në perceptimin tim, PASTROMË ZOT). (Psalmi 18, 13).
273. GJITHÇKA QË MBAJMË MEND DHE NA RËNDON QË NGA MOSHA SHTATË VJEÇARE E SIPËR QOFTË E VOGËL APO E MADHE.
274. DUHET TË RRËFEHEMI KUR NJË KRYEPRIFT APO PRIFT NA KA SHKISHËRUAR APO NËSE NA KA MALLKUAR ETJ.



## RRËFIM DASHURIE

*Po ju jap një urdhërim të ri: ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur, ashtu edhe ju ta doni njëri-tjetrin. Prej kësaj do t`ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin. (Joani 13, 34-35)*

*Ky është urdhërimi im: ta doni njëri-tjetrin, ashtu si unë ju kam dashur juve. (Joani 15, 12)*

Himni i dashurisë i Apostull Pavlit (1 Korint. 13, 4-7)

*Dashuria është zemërgjërë, është e dhimbshme, dashuria,  
nuk ka smirë, nuk mbahet me të madh, nuk krenohet; nuk është e  
panjerëzishme, nuk kërkon interesin e vet,  
nuk hidhërohet, nuk e mban mend të keqen,  
nuk i kënaqet padrejtësisë, por i gëzohet të vërtetës.  
Arsyeton gjithçka, beson gjithçka; shpreson gjithçka, duron gjithçka.*

## RRËFIMI

DASHURIA QË KAM NUK KA DHEMBSHURI.

DASHURIA QË KAM NUK TREGON MIRËSI.

DASHURIA QË KAM KA ZILI.

DASHURIA QË KAM ËSHTË ARROGANTE.

DASHURIA QË KAM FRYHET NGA KRENARIA.

DASHURIA QË KAM SILLET SHËMTUAR.

DASHURIA QË KAM ËSHTË EGOISTE.

DASHURIA QË KAM SHIKON INTERESIN E SAJ.

DASHURIA QË KAM ËSHTË PEZMATUESE.

DASHURIA QË KAM MBAN MËRI.

DASHURIA QË KAM GËZOHET PËR TË KEQEN.

DASHURIA QË KAM NUK MERR PJESË NË GËZIMIN PËR TË  
MIRËN.

DASHURIA QË KAM NUK MBRON, NUK BESON, NUK  
SHPRESON, NUK DURON.

«Zot dhe Perëndi! Sa shumë mëkate të tmerrshme që ka brenda  
meje të cilat deri tani nuk i kisha zbuluar!»

ZOT UNË SI NJERI MËKATOVA, POR TI SI PERËNDI DHE  
KRIJUES KIJ MËSHIRË PËR MUA.

Lutje e Shen Efrem Sirianit

**para se të flesh**

Zot dhe Perëndia im Jisu Krisht, Ti që e tregove nënën Tënde të  
shenjtë më të nderuar se të gjithë fuqitë qiellore, Ti, o i Tërëmirë,  
me ndërmjetimet e saj dhe të gjithë shenjtorëve të Tu, kij mëshirë  
dhe fale shërbëtorin Tënd të padenjë, për çdo faj që kam bërë ditën  
e sotme si njeri, më saktë si qenie jo njërezore, të gjitha fajet që kam  
bërë me dashje apo pa dashje. Ato që kam bërë nga dija dhe padija,  
ato që kam bërë nga nxitimi dhe pakujdesia dhe ato që kam bërë  
nga plogështia ime e shumtë dhe nga neglizhenca. Dhe nëse me  
mendje u betova në emrin Tënd dhe nëse e shkela betimin dhe  
nëse blasfemova apo të zemërova. Dhe nëse qava apo gënjeva, dhe  
nëse nuk i dhashë rëndësi miqve që ishin pranë meje dhe nëse  
trishtova apo gjykova vëllain tim. Dhe nëse gjatë lutjes dhe psaljes,  
mendja ime dinake shkonte në ligësi dhe vraponte në kënaqësi të  
liga. Dhe nëse fola hokatarisht apo qesha pamaturisht, dhe nëse  
tregova mendjemadhësi, dhe nëse u krenova, dhe nëse shikova  
bukuri të kota dhe me anë të saj ushqeva mendjen time  
dinakërisht. Dhe nëse thashë fjalë të shëmtuara apo nëse gjykova  
dhe qortova të metat e vëllait tim, ndërsa ndaj të metave të mia të  
shumta nuk ju dhashë rëndësi, dhe nëse neglizhova lutjen dhe

gjithçka tjetër dinake që mendova. Të gjitha këto dhe gjithë të tjerat të cilat bëra dhe nuk më kujtohen, falmë o Perëndi mua shërbëtorin Tënd të pacipë, dhe mëshiromë si i Mirë dhe Njeridashës.

Që të fle me paqe unë plangprishësi, Të lavdëroj bashkë me Atin dhe Shpirtin e Tij të Tërëshenjtë, të mirë e jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin

## LUTJE

«Zot Të lutem të më falësh për të gjitha mëkatet që kam bërë që atëherë kur mbaj mend veten time deri më sot. Më fal për çdo gjë që them, bëj, mendoj, ndiej, ha, pi dhe që nuk është e saktë. Dhe për të shkuarën dhe për të tashmen. Dhe më denjëso që të bindem sepse është për të mirën time, të adhuroj, të dua dhe të ndjek ashtu siç duhet, të zbatoj porositë e Tua që të shpëtohem. Amin»

*Uroj që Perëndia me ndërmjetimet e jerondëve oshënarë nga Mali i  
Shenjtë Pais & Porfir të ndihmojë shpirtërisht dhe trupërisht  
njeriun që vuan, në mënyrë që të gjejë shërimin dhe shpëtimin e tij.*

*Librat e mëposhtëm shpërndahen për laudi të Perëndisë Triadike.*

*Për këtë arsye formuloam këtë përmbledhje të ligjëratave të Jerond Paisit dhe të Jerond Porfirit me temat e mëposhtme:*

- FUQIA E RRËFIMIT (Jerond Paisi, Jerond Porfiri).
- SPROVA – SËMUNDJE (Jerond Paisi, Jerond Porfiri).
- PËRGJEGJËSIA E PRINDËRVE PËR EDUKIMIN E FËMIJËVE (Jerond Paisi, Jerond Porfiri).
- PËR NJË FAMILJE TË PATUNDUR (Jerond Paisi, Jerond Porfiri).
- PËRBALLIMI I VDEKJES DHE JETA E ARDHSHME (Jerond Paisi).
- MREKULLI DHE GJATË JETËS DHE PAS VDEKJES (Jerond Paisi).
- DUKE NDIHMUAR TË RINJTË (Jerond Paisi).
- SHENJAT E KOHËVE (Jerond Paisi).
- FUQIA LUTËSE DHE SHËRUESE E PSALMEVE Oshënar Arseni nga Kapadhokia.

SHPËRNDAHET FALAS

Pamje e brendshme nga Panagudha brenda së cilës Jerond Paisi

«mbështeti botën me lutjen e tij»